

ARRITJE NE LUFTEN KUNDER KORRUPSIONIT

2009

I. Raporte te Organizatave Nderkombetare

Indeksi i Perceptimit te Korrupsionit

Transparency International ka njohur permiresim te ndjeshem, nga 2,4 ne vitin 2005 eshte ngritur ne 2,6 ne vitin 2006, ne 2,9 ne vitin 2007, ne 3.4 per vitin 2008 dhe se fundmi ne 3.2 ne vitin 2009.

Nese ne vitin 2007 Shqiperia ka bere nje permiresim teper te ndjeshem me 0,5 pike duke u renditur ne vendin e 85 nga 180 vende te vleresuara, gjate vitit 2008-2009 eshte vene re nje zbritje e lehte me 0,2 pike. Kjo zbritje eshte brenda marzhit te gabimit te metodikes (metodike e re e perdorur ne 2009 dhe numer burimesh me i madh) se perdorur ne sondazh dhe mund te konsiderohet edhe si pasoje e fushates elektorale ne vend, retorika e te ciles ndikon drejtperdrejt ne perceptimin e korrupsionit.

Millennium Challenge Corporation

(Annual country scorecards - <http://www.mcc.gov> - akeluar ne 10. 11.2009)

Klasifikuar me 0.9 ose 53% ne drejtim te kontrollit te korrupsionit. Me kete rezultat, Shqiperia i afrohet programit “Kompakt”, i cili eshte forma me e larte e ndihmes qe parashikon MCC.

Sondazhi i fundit i kryer nga IDRA 2009

Tregon nje ulje te incidences se korrupsionit. Megjithse perceptimi i korrupsionit eshte rritur (por duhet theksuar qe perceptimi ndikohet nga debati publik), *Viktimizimi i raportuar nga korrupsioni* ka pësuar rënie në vitin 2009 krahasuar me vitin 2005. Nga 10 mënyra përmes të cilave një person mund të viktimizohet nga korrupsioni, numri mesatar i tyre për vitin 2009 është 1.29 ndërkohë që në vitin 2005 ka qenë 1.7 Në përgjithësi, përvoja me korrupsionin është ulur. Pothuasje në të gjithë skenarët e përfshirë në pyetësor ka një rënie në përqindjen e personave, të cilët deklarojnë se kanë paguar ose u është kërkuar të paguajnë ryshfet. I vetmi përjashtim është përvoja me korrupsionin në sistemin

shëndetësor e cila nuk ka ndryshim. Nëse përjashtojmë këtë sektor nga llogaritja atëherë vetëm 35% e të intervistuarve kanë raportuar të paktën një përvojë me korrupsionin gjatë 12 muajve të kaluar.

Grupi i Shteteve Kunder Korrupsionit (GRECO)

- Ne Maj të vitit 2009 janë miratuar dhe adoptuar raportet për Republikën e Shqipërisë në lidhje me Raundin e 3 të vleresimit nga GRECO për temat e *Inkriminimit të Veprave Korruptive dhe Transparencës së Financimit të Partive Politike*. Këtu mund të përmendim që Shqipëria është vlerësuar shumë pozitivisht në krahasim me të gjithë vendet e vlerësuara deri më sot, (përkatesisht me 5 rekomandime për inkriminimet dhe 7 rekomandime për transparencën e financimit të partive politike).
- Në Tetor të vitit 2009 Shqipëria ka mbyllur Raundin e 2 të vleresimit nga GRECO me temat; *Identifikimi, kapja, konfiskimi i procedurave të korrupsionit, Parandalimi dhe gjetja e korrupsionit në administratën publike dhe Parandalimi i personave ligjorë (koorporatave etj.) të përdorura si vegla për korrupsion*. Shqipëria është vlerësuar mjaft pozitivisht pasi ka plotësuar plotësisht 11 nga 13 rekomandimet e GRECO-s të lëna nga raporti i vleresimit. Një rekomandim është konsideruar pjesërisht i plotësuar dhe vetëm një rekomandim është konsideruar i paplotësuar.

II. Instrumentat e luftës kundër korrupsionit

Keto tregues dhe raportime të organizmave me prestigjioze të fushës konfirmojnë suksesin e përpjekjeve të qeverisë në luftën kundër korrupsionit. Arritjet kanë në themel:

- i) *Qasjen e re strategjike*, Qeveria po zbaton **Strategjinë për Parandalimin, Luftën kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente**, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2008-2013. Kjo strategji e miratuar me VKM në 3 tetor 2008 përcakton drejtimet kryesore të luftës kundër korrupsionit: masat dhe reformat që synojnë parandalimin, si dhe masat për hetimin zbulimin dhe ndeshkimin e korrupsionit dhe atyre që bëjnë korrupsion; në vijim dhe për zbatimin e saj Grupi Nderministror i Punës ka miratuar dhe Planin e Integruar të Veprimit 2009. Ky grup është struktura përgjegjëse monitoruese për zbatimin dhe rishikimin e strategjisë dhe planeve vjetore të integruara.

- Nje projekt i vecante ne lidhje me Luften kunder korrupsionit prej 2,1 milion euro eshte miratuar dhe ka filluar implemtimi ne dhjetor te 2009. Qellimi i ketij projekti eshte:
 - Zbatimi i strategjise anti-korrupsion si dhe rekomandimeve te GRECO-s dhe MONEYVAL.
 - Nje fokus specifik i dedikohet luftes se korrupsionit ne fushen e arsimit.
- ii) *Ngritjen e nivelit te pergjegjshmerise politike te struktures institucionale pergjegjese per luften kunder korrupsionit. **Task Force Antikorrupsion**, e cila drejtohet nga Kryeministri dhe ne te bejne pjese ministrat kryesore dhe drejtuesit e departamenteve qe mbulojne kryesisht manaxhimin e financave publike si dhe njesite/ departamentet e auditimit dhe kontrollit. TFA ka nje qasje me dinamike ndaj fenomenit te korrupsionit dhe synon te aktivizoje kapacitetet e administrates per te reaguar ne menyre te shpejte energjike dhe procedurale ndaj shfaqjeve te praktikave korruptive, abuzimeve, apo deformimeve te ndryshme ne administrate. Gjate vitit 2009, ajo ka shqyrtuar ceshtjen e korrupsionit ne fushen e shendetsise dhe per rrjedhoje nje sere rreformash jane ndermarre ne kete drejtim.*

III. Masat me karakter parandalues

Ne fushen e Drejtesise

Për realizmin e transparencës së procesit gjyqësor dhe rritjen e besimit të publikut tek gjykatat, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë të Drejtësisë dhe USAID kanë nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit, i cili përcakton rregulla dhe modalitete mbi zbatimin e një projekti pilot në 10 gjykata të rretheve gjyqësore. Ky projekt asistohet nga USAID dhe fokusohet:

- i. në përmirësimin e kushteve teknike (pajisjen me kompjutera, printera, pajisje për videokonferenca;
- ii. në trajnimin e personelit të administratës gjyqësore;
- iii. në trajnimin e gjyqtarëve për shkrim dhe arsyetim ligjor;
- iv. në menaxhimin dhe administrimin e dokumentacionit që përmbajnë arkivat e sistemit gjyqësor. Me urdhrin nr. 2583, datë 11.04.2009 të Ministrit të Drejtësisë është miratuar “*Rregullorja për Arkivat e Sistemit Gjyqësor*”, Gjithashtu, pranë Ministrisë së Drejtësisë me Urdhërin nr. 2583/5, datë 14.05.2009 është krijuar Komisioni i Ekspertizës për Arkivin e Sistemit Gjyqësor, i cili në mbështetje të Urdhërit nr. 2583/6, datë 14.05.2009 “*Për miratimin e listave tip të dokumentave me afatet e ruajtjes dhe asgjësimit të dokumentave të gjykatave*”, shqyrton dhe

vendos mbi kategorizimin e dosjeve për asgjësim, në formatin e Listës Tip “Për afatin e ruajtës dhe asgjësimit të dosjeve”.

Ministria e Drejtësisë ka synuar trainimin e vazhdueshëm të administratës gjyqësore, në vijim edhe të projektit të financuar nga Këshilli i Evropës dhe Komisionin Evropian. Sipas këtij projekti janë organizuar disa seminare në Shqipëri dhe vizita studimore në Francë, Rumani, Austri, Gjermani dhe në Portugali me qëllim trajnimin e administratës gjyqësore, në veçanti të kancelarëve (administratorëve ligjore) dhe kryesekretareve në gjykata. Gjatë vitit 2009 janë trajnuar nga USAID mbi 50 punonjës të gjykatave pilot, mbi procedurën e ruajtjes dhe të asgjësimit të dosjeve gjyqësore në arkivat e gjykatave të tyre.

Trajtime janë zhvilluar edhe nga Shkolla e Magjistraturës, në mbështetje të ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996 “Për shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 9414, datë 20.05.2005, e cila ka përgatitur Programin Tematik të Trajnimit vazhdues 2009 – 2012 (të miratuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues, në datë 15.07.2009), në të cilin përfshihet edhe trajnimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve, në fushën e luftës kundër korrupsionit, me temat:

- a) Trajnime të njëjësive hetimore antikorrupsion (prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore).
- b) Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbimin publik. Korrupsioni aktiv dhe pasiv, në këndvështrimin e Konventave ndërkombëtare dhe praktikës sonë gjyqësore.

Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të mëtejshëm të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe IFC, gjatë vitit 2009 ka vazhduar projekti pilot në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili fokusohet në sensibilizimin dhe rritjen e numrit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve nëpërmjet rrugës jashtëgjyqësore të ndërmjtësimit, duke bërë të mundur në këtë mënyrë: uljen e numrit të çështjeve për gjykim (ulja e mbingarkesës së punës të gjyqtarëve), uljen e kostove të procesit, rritjen e shpejtësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe rritjen e transparencës në këtë sistem.

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 20, datë 14.1.2009, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”, i cili përcakton strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të administratës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. Kjo iniciativë realizoi rritjen e pagave të administratës gjyqësore duke bërë të mundur përmirësimin e statusit të tyre përkundrejt detyrave në rritje, të cilat vijnë si rezultat i miratimit të një sërë akteve ligjore që përmirësojnë gjyqësorin shqiptar, në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë.

Në kuadër të plotësimit të kuadrit të mësipërm ligjor të përmirësimit të statusit të gjyqtarëve, janë miratuar:

- VKM nr. 480, datë 6.5.2009 “Për mbrojtjen e veçantë personale, familjare dhe të pronës së gjyqtarëve, sigurimin e jetës dhe pronës së tyre”.
- VKM nr. 20, datë 14.1.2009 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”.
- VKM nr. 49, datë 14.01.2009 “Për një shtesë në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, të ndryshuar”.

Gjatë vitit 2009 janë hartuar nga Ministria dhe Drejtësisë dhe më pas janë miratuar nga Presidenti i Republikës:

- Dekreti nr. 6201, datë 08.06.2009 “Për përcaktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë të secilës prej tyre”.
- Dekreti nr. 6218, datë 07.07.2009 “Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”.
- Dekreti nr. 6217, datë 07.07.2009 “Për caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së gjykatave të apelit”.
- Dekreti Nr. 6265 ,datë 16.09.2009 “Për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit”.

Në zbatim të ligjit nr. 10 031, datë 11/12/2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, dhe ligjit nr. 10 052, datë 29.12.2008 “Për shtesat dhe ndryshimet në ligjin nr. 8116, datë 29/03/1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” janë hartuar, dhe miratuar njw swrw aktesh nwnligjore si; Udhëzimi nr. 13, datë 12.02.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar, i cili përcakton marzhe financiare konkrete mbi shërbimet e kryera nga operatorët e përcaktuar të sistemit të drejtësisë, Urdhri nr. 3851, datë 08.05.2009, të Ministrit të Dejtësisë për miratimin e “Kodit të Etikës së përmbartuesve gjyqësor shtetëror dhe privat”, i cili parashikon rregulla dhe norma mbi mënyrën e sjelljes dhe komunikimit të këtyre operatorëve etj.

Iniciativa të tjera ligjore të ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2009, në kuadër të realizimit me efektivitet të luftës kundër korrupsionit, jane:

Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i cili synon të përmirësojë kuadrin ligjor që normon procedurat e sekuestrimit dhe të konfiskimit të aseteve të paligjshme të krijuara nga krimi i organizuar si mjet efikas për goditjen dhe parandalimin e tij. Konkretisht, objekti i këtij ligji konsiston në përcaktimin e procedurave, kompetencave dhe kriterëve për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikimit. Në tërësi, risitë që përmban ky ligji kanë të bëjnë me:

- Reformimin e konceptit të veprimit të ligjit duke e shndërruar si procedurë ndaj pasurisë, dhe jo më si procedurë ndaj personave;
- Ndarjen e qartë të procedurës civile të këtij ligji nga ajo e procesit penal të sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale. Për këtë qëllim u reformua kalimi i barrës së provës tek zotëruesi i pasurisë dhe është ulur standardi i të provuarit të veprimtarisë kriminale (duke përdorur tashmë indiciet);
- Përmirësimin e procedurave për vendosjen e masës së sekuestrimit dhe të konfiskimit;
- Përmirësimin e procedurave të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- Përmirësimin e rregullave për destinimin e pasurive të konfiskuara.

Procesi i hartimit të këtij ligji kaloi përmes një procedure të gjerë konsultimi si me agjencitë e zbatimit të ligjit (organi i Prokurorisë, Gjykatës për Krime të Rënda, Policia e Shtetit dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara), ashtu edhe me partnerët ndërkombëtarë (ku duhen veçuar EURALIUS, OPDAT, PAMECA, madje në stadin e fundit edhe OSBE), si dhe me procedurën e bashkërendimit ndërministror duke kërkuar mendim dhe reflektuar sugjerimet eventuale të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Integritetit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Ky ligj përbën një instrument shumë efikas për organet e drejtësisë në luftën e tyre me sukses kundër krimit të organizuar; si dhe materializon angazhimin dhe përpjekjet e Qeverisë Shqiptare kundër krimit të organizuar nën moton “Zero Tolerancë ndaj Krimit”.

Gjithashtu, ky ligj një bazë të nevojshme financiare në funksion të përmirësimit të drejtësisë penale, si dhe për ndihmën e viktimave të krimit të organizuar.

Ligji nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i cili plotëson rregullat procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar dhe është në përputhje me këtë Kod dhe dispozitat e tij zbatohen kur marrëveshjet ndërkombëtare në të

cilat Republika e Shqipërisë është palë, nuk parashikojnë ndryshe. Ky ligj është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me organizmat ndërkombëtare të tilla si: Misioni EURALIUS, pranë Ministrisë së Drejtësisë, OPDAT, PROSECO dhe KE, si dhe me institucionet shqiptare të përfshira në procesin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

1) Plotësimi me akte nënligjore i ligjit “Për liberalizimin e shërbimit të përmbarimit”, duke përgatitur paketën e akteve nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji – lidhur me këtë objektiv të realizuar gjatë vitit 2009, më konkretisht informoj si vijon:

Në zbatim të ligjit nr. 10 031, datë 11/12/2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, dhe ligjit nr. 10 052, datë 29.12.2008 “Për shtesat dhe ndryshimet në ligjin nr. 8116, datë 29/03/1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar janë hartuar, dhe miratuar këto akte nënligjore:

- i. Udhëzimi nr. 13, datë 12.02.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar, i cili përcakton marzhe financiare konkrete mbi shërbimet e kryera nga operatorët e përcaktuar të sistemit të drejtësisë.
- ii. Urdhri nr. 3851, datë 08.05.2009, të Ministrit të Dejtësisë për miratimin e “Kodit të Etikës së përmbaruesve gjyqësor shtetëror dhe privat”, i cili parashikon rregulla dhe norma mbi mënyrën e sjelljes dhe komunikimit të këtyre operatorëve;
- iii. Urdhri nr. 3852, datë 08.05.2009, të Ministrit të Drejtësisë për miratimin e “Rregullores për përbërjen e Komisionit Vlerësues, rregulla të funksionimit të tij, procesi i përzgjedhjeve, kriterëve, procedurave të organizimit dhe shpalljes së rezultateve të provimit për përmbaruesit privat”, i cili parashikon rregulla, kushte dhe kriterë mbi mënyrën e organizimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për përmbarues privat.

Është hartuar Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 2106, datë 02.03.2010 “Për organizimin e provimit të kualifikimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë”, dhe në datën 5 prill 2010, është caktuar zhvillimi i provimit të kualifikimit për ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesve gjyqësorë privatë. Vënia në funksionim të shërbimit përmbarimor privat do të ndihmojë në përmirësimin e situatës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, veçanërisht në rastet kur debitor është shteti.

2) Instalimi i sistemit CCIMS – lidhur me realizimin e këtij objekti informoj si vijon:

Ky projekt është financuar nga Bashkimi Europian në vlerën e rreth 270 mijë euro. Nga grupi i ekspertëve i ngritur për vënien në funksionim të këtij sistemi u konstatuan një sërë problemesh, të cilat nuk mundësonin arritjen e qëllimit të instalimit të tij, sikurse ishte: standartizimi i dosjes gjyqësore, rritja e aksesit dhe dalja në ëeb të gjykatave dhe publikimit të vendimeve gjyqësore, gjenerim të statistikave të sakta dhe raporteve të performancës në çdo gjykatë. Ky projekt për shkak të probleme që paraqiti, ju kthye Bashkimit Europian, të cilët në referim të domosdoshmërisë së ekzistencës së një sistemi online, propozuan pranimin e pjesshëm të këtij sistemi, duke i lënë si afat kohor gjithë vitin 2009 firmës përgjegjëse DATECH, për rregullimin dhe sistemin e problemeve të konstatuara. Në kushtet e mësipërme, Ministri i Drejtësisë, në mbështetje edhe të politikës së re të Qeverisë Shqiptare mbi *dixhitalizimin e sistemeve operative*, në muajin korrik 2009, nxorri urdhrin nr. 60/40/2, datë 23.07.2009 “Për procedurën e prokurimit me mjetet elektronike të sistemit për lidhjen në rrjet të Ministrisë së Drejtësisë me gjithë gjykatat”, nëpërmjet të cilit do të mundësohej prokurimi i sistemit online të gjyqësorit, më synim arritjen e transparencës së plotë të këtij sistemi. Në lidhje me vënien në funksionim të këtij projekti u planifikua një shumë prej 13.130.000 lekë, të cilat do të mbuloheshin nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Ky proces nuk u realizua për shkak të një problemeve teknike në këtë periudhë të faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Aktualisht, në sistemin gjyqësor shqiptar aplikohen dy sisteme të ndryshme të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sistemi “ARK-IT” dhe sistemi “CCMIS/ICMIS” . Sistemi ARK-IT është në përdorim ende në 6 Gjykata të Rretheve Gjyqësore (Tiranë, Kavajë, Vlorë, Fier, Shkodër dhe në Gjykatën për Krimet e Rënda) për disa arsye teknike të sistemit CCMIS/ICMIS, për zgjidhjen e të cilave është duke u punuar në bashkëpunim me ekspertët e misionit EURALIUS II. Sistemi CCMIS/ICMIS është në përdorim në të gjitha gjykatat e tjera, si dhe në Gjykatën e Lartë. Për konsolidimin, unifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit CCMIS/ICMIS (zëvendësimin e plotë të sistemit ARK-IT) në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010 janë parashikuar nga qeveria shqiptare një fond investimi prej 98440.10 Euro.

3) Reflektimi i rekomandimeve të GRECO-s – lidhur me këtë objektiv informoj si vijon:

Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit, në Ministrinë e Drejtësisë, në muajin Tetor 2009 ka analizuar rekomandimet e paraqitura në Raportin e Raundit të Tretë të Vlerësimit të GRECO dhe ka evidentuar ndërhyrjet në legjislacion. Në bazë të evidentimit të ndërhyrjeve të nevojshme ligjore, u hartua drafti paraprak që ka të bëjë me përfshirjen e veprave të reja penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht:

- 1) Një ndër rekomandimet e GRECO është rritja e maksimumit të dënimeve për veprat e korrupsionit në sektorin privat me qëllim uljen e diferencës që ekziston midis masës së dënimit në këtë sektor dhe masës së dënimit për korrupsionin në sektorin publik. Për këtë arsye, është evidentuar ndryshimi i neneve 164/a dhe 164/b të Kodit Penal, duke ashpërsuar dënimin për veprën penale të korrupsionit aktiv në sektorin privat nga 2 vjet në 3 vjet (neni 164/a) dhe ashpërsimin e dënimit për korrupsionin pasiv në sektorin privat (neni 164/b) nga 3 vjet në 8 vjet.
- 2) GRECO ka rekomanduar të kryhen ndërhyrjet e duhura legjislative në përputhje me nenet 5, 6, 9, 10 dhe 11 të Konventës Penale mbi Korrupsionin. Në zbatim të këtij rekomandimi, janë evidentuar shtesa në Kodin Penal duke parashikuar vepra të reja penale korruptive, si:
 - i. Korrupsioni aktiv dhe pasiv i nëpunësve të huaj publikë, nëpunësve të një organizate publike ndërkombëtare, anëtarëve të asambleve të huaja publike, anëtarëve të asambleve ndërkombëtare parlamentare (neni 244/a dhe neni 259/a);
 - ii. Korrupsioni aktiv dhe pasiv i gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/a dhe neni 319/dh).
- 3) Lidhur me rekomandimin e mësipërm GRECO ka parashikuar sigurimin e juridiksionit mbi të gjithë veprat penale të korrupsionit në sektorin publik dhe privat dhe ushtrimin të ndikimit të paligjshëm të kryera jashtë shtetit nga:
 - i. nga shtetas shqiptarë, zyrtarë publikë shqiptarë ose anëtarë të asambleve publike shqiptare;
 - ii. të përfshihen zyrtarët publikë shqiptarë, anëtarët e asambleve publike shqiptare ose zyrtarët e organizatave ndërkombëtare, anëtarët e asambleve ndërkombëtare parlamentare ose gjyqtarët/zyrtarët e gjykatave ndërkombëtare me shtetësi shqiptare.
- 4) Lidhur me rekomandimin e GRECO për të siguruar juridiksion mbi veprat penale të korrupsionit, të kryera jashtë shtetit nga shtetas shqiptarë, zyrtarë publikë shqiptarë ose anëtarë të asambleve publike shqiptare, neni 6 i Kodit Penal parashikon se ligji penal i

Republikës së Shqipërisë zbatohet për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe për krime të kryera nga shtetasit shqiptarë në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj (parimi i shtetësisë). Për këtë arsye, nuk është e nevojshme të shtohen nene të tjera në Kodin Penal në zbatim të këtij rekomandimi.

5) Një tjetër rekomandim i GRECO është kryerja e ndërhyrjeve të duhura legislative në mënyrë që të sigurohet që anëtarët e jurive të huaja si dhe arbitrat vendas dhe të huaj të përfshihen shprehimisht në veprat penale të korrupsionit në Kodin Penal, në përputhje me Protokollin shtesë të Konventës Penale mbi Korrupsionin. Në zbatim të këtij rekomandimi, janë evidentuar të shtohen në Kodin Penal vepra të reja penale si:

- i.* Korrupsioni aktiv dhe pasiv i arbitrave vendas dhe të huaj (neni 319/b dhe neni 319/d);
- ii.* Korrupsioni aktiv dhe pasiv i anëtarëve të huaj të jurisë (neni 319/c dhe neni 319/dh).

6) Në referim të parashikimeve aktuale ligjore të legjislacionit shqiptar veprat e reja penale të korrupsionit lidhur me zyrtarët e huaj, i referohen edhe personave pa shtetësi që ushtrojnë funksionet përkatëse në bazë të parashikimeve të veçanta (referenca ligjore në ligjin nr. 9959/2008 “Për të huajt”, sipas të cilit “i huaj” konsiderohet çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar).

7) Lidhur me korrupsionin në financimin e partive, ky është projekt që do të ndiqet nga Këshilli i Ministrave/KQZ.

4) Ndryshimi i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” për qartësimin e kompetencave mes dy inspektoriateve të kontrollit të gjyqësorit, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë – lidhur me këtë objekt informoj si vijon:

Inicimi i hartimit të këtij projekligji e ka zanafillën në muajin Prill të vitit 2008, kur është formuar për herë të parë grupi i punës, i cili do të hartonte dispozitat konkrete, kryesisht, lidhur me qartësimin dhe saktësimin e kompetencave të Inspektoratit të KLD-së. Nga anëtarët e grupit të punës dhe njëkohësisht përfaqësues të institucioneve dhe organizmave të huaja janë servirur teza dhe sugjerime mbi platformën e hartimit të dispozitave shtesë

dhe ndryshuese. Grupi i punës gjatë takimeve, të pakta në numër që ka zhvilluar, është përqëndruar, kryesisht me mbledhjet e materialeve për hartimin e projektpolitikës me qëllim inicimin e draftimit të dispozitave përkatëse. Për shkak të zëvendësimit të një pjese të anëtarëve të këtij grupi, gjatë vitit 2009 lindi nevoja e riformatimit të tij. Në muajin tetor 2009, në bazë të materialeve të mbledhura nga grupi i mëparshëm i punës, procesi i hartimit të ndryshimeve në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, u transferua pranë Sektorit të Hartimit të Legjislacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit. Janë përcaktuar disa nga çështjet kryesore që kërkojnë vëmendje në rregullimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të ndryshuar, të cilat lidhen kryesisht me përcaktimin e qartë dhe të saktë të kompetencave të Inspektoratit të KLD-së dhe raportet e tij me Inspektoriatin e Ministrisë së Drejtësisë.

Aktualisht, hartimi i këtij projektakti sipas planit legjislativ të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010, është planifikuar të përfundojë gjatë 4-mujorit të dytë të vitit 2010.

5) Hartimi i akteve nënligjore, për projektligjin “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative” dhe projektligjin “Për administratën gjyqësore”, duke parashikuar përgatitjen e paketës me këto akte nënligjore pas miratimit të dy projektligjeve të sipërcituara – paketat e akteve nënligjore nuk janë hartuar pasi dy iniciativat e Ministrisë së Drejtësisë nuk janë miratuar në Parlament.

Konkretisht, lidhur me këto dy iniciativa të Ministrisë së Drejtësisë, informoj si vijon:

a) Projektligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative”, u miratua nga Këshilli i Ministrave në 01.10.2008 dhe iu nënshtrua një procesi konsultimi të gjerë në Komisionin e Ligjeve me subjektet e interesuara. Megjithatë, edhe pas këtij momenti, Ministria e Drejtësisë ka ofruar asistencë në Komisionin e Ligjeve për formulimet e dispozitave të sugjeruara nga grupet e interesit dhe anëtarët e Komisionit të Ligjeve, përgjatë seancave dëgjimore. Projektligji është miratuar nga Komisioni i Ligjeve në Kuvend, u përfshi në rendin e ditës për t’u miratua në seancë plenare. Ai mbeti pa u miratuar në legjislaturën e kaluar të Kuvendit (2008-2009), për shkak të mungesës së opozitës në Kuvend sepse ky ligj në bazë të nenit 81 pika 2 të Kushtetutës duhet miratuar me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Miratimi i këtij ligji është në varësi të zhvillimeve politike në Kuvend.

b) Projektligji “për administratën gjyqësore”, u miratua nga Këshilli i Ministrave por mbeti në diskutim në Komisionin e Ligjeve në Kuvend. Ministria e Drejtësisë mbetet në pritje të një qëndrimi nga Komisioni i Ligjeve dhe nga Këshilli i Ministrave mbi këtë

projektligj. Projektligji i draftuar ka si qëllim përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të administratës gjyqësore, kushtet dhe procedurat e rekrutimit në punë, mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, zhvillimin e karrierës, si dhe garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të punonjësve të administratës gjyqësore, duke përcaktuar për herë të parë dhënien e statusit administratës gjyqësore dhe duke bërë një rritje të ndjeshme të rrogave të tyre.

6) Nënshkrimi i memorandumeve të tjera me vendet e BE-së e më gjerë, për të siguruar përputhshmërinë e kuadrit ligjor me konventat penale e civile kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës – lidhur me këtë objektiv informojmë se nga Ministria e Punëve të Jashtme nuk është paraqitur asnjë propozim pranë Ministrisë së Drejtësisë, për fillimin e negociatave, me vendet e BE-së ose më gjerë, për nënshkrimin e projekt marrëveshjeve ose projektmemorandumeve në këtë fushë (lider për realizimin e këtij objektivi është Ministria e Punëve të Jashtme).

7) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8677, datë 02/11/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar”, i planifikuar për t’u realizuar brenda vitit 2009, u ndërpre sepse grupi ndërinstitucional i punës për përmirësimin e paketës ligjore që rregullon marrëdhëniet polici gjyqësore-prokurori, nuk dha rezultat.

Pas shtatorit 2009 është urdhëruar nga Ministri i Drejtësisë iniciimi i procedurave për hartimin e kësaj nisme ligjore, që synon përmirësimin e ligjit ekzistues për ta përputhur me zhvillimet e sjella nga ligjet e miratuara në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë, dhe kryesisht, reformimit të sistemit të pushtetit gjyqësor.

Me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 8472/1, datë 10/11/2009 është ngritur grupi i punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8677, datë 02/11/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar”. Në bazë të këtij urdhri është hartuar drafti i projektpolitikës mbi evidentimin e ndërhyrjeve ligjore në ligjin nr. 8677/2000, të cilat konsistojnë në:

- i. përmirësimin e rregullave mbi kushtet dhe procedurën e rekrutimit, përzgjedhjes, promovimit, fillimit e ecures së procedurës disiplinore së tyre;
- ii. përmirësimin e statusit të oficerit të policisë gjyqësore lidhur me rritjen e pagës, përfitimeve materiale dhe profesionale;
- iii. përcaktimin e rregullave në bazë të të cilave rregullohen marrëdhëniet funksionale ndërmjet policisë gjyqësore dhe prokurorisë.

Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 8472/2, datë 10/11/2009, me shkresën nr. 8472/2 prot., datë 03/12/2009 është kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Brendshme, caktimi i përfaqësuesit në grupin e punës për hartimin e dispozitave ndryshuese dhe shtuese në ligjin ekzistues.

Duke filluar nga muaji janar 2010, grupi i punës zhvillon mbledhje çdo javë për ezaurimin e hartimit të kësaj iniciative. Në këtë grup punë janë ftuar të marrin pjesë edhe përfaqësues të misioneve të huaja si: EURALIUS, OPDAT, PAMECA, dhe të tjera misione.

Kjo iniciativë, sipas planit legjislativ të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010, është planifikuar të përfundojë gjatë 4-mujorit të dytë të vitit 2010.

Ne fushen e arsimit dhe shkences

Jane hartuan akte të ndryshme normativë, u përmirësuan procedurat për disa nga praktikatat kryesore të punës në sistemin arsimor. Konkretisht përmendim:

- Vendimin nr. 762, datë 28.05.09 2009 të Këshillit të Ministrave, *Për miratimin e Projekt – Ligjit “Per Kornizen Shqiptare te Kualifikimeve”*. Miratimi i saj, krijon mundësinë që diplomat dhe çertifikatat e dhëna që nga viti i ardhshëm akademik të jenë në përputhje me standardet evropiane të kualifikimeve. Kjo nuk shënon vetëm një përputhshmëri të mëtjshme me legjislacionin evropian por edhe një rritje të transparencës në procesin e njohjes së kualifikimeve, duke i prerë rrugën çdo abuzimi apo veprimi korruptiv lidhur me to.
- Me miratimin e Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 *“Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*, u bë e mundur ngritja e Qendrës Kombëtare të Liçensimeve. Funkcionimi i një qendre të vetme, thjeshton dhe i bën me transparente procedurat e aplikimit për institucionet arsimore private. Të interesuarit mund të marrin informacion dhe të aplikojne në cdo moment nëpërmjet sistemit on-line.
- Me Urdhërin e MASH nr. 32, datë 12.02.2009, *“Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve të lirimimit në shkollat 9 – vjeçare për vitin shkollor 2008 – 2009”*, u bë i mundur për herë të parë vlerësimi i jashtëm në arsimin bazë. Korrigjimi i testeve tanimë bëhet jashtë shkollës, në nivel DAR/ZA dhe nga mësues të caktuar. Praktika e re rrit objektivitetin e procesit dhe transparencën, duke i prerë rrugën ndonjë veprimi korruptiv gjatë procesit mësues, si dhe nxit vlerësimin real të dijeve.

- Udhëzimi i MASH nr. 5, datë 18.02.2009, “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Udhëzimi i MASH nr. 7, datë 18.02.2009, “Për Suplementin e Diplomës”, Udhëzimi i MASH nr. 12, datë 18.02.2009, “Për krijimin e Regjistrit Shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Këshillat Shkencorë”, janë disa akte ligjore, që përveç përafrimit me Legjislacionin Evropian synojnë shmangjen e çdo tentative falsifikimi e korrupsioni në lëshimin e diplomave e çertifikatave të ndryshme.
- Udhëzimi i MASH nr. 3, datë 27.01.2009, “Për detajimin e Buxhetit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë”, siguroi këtë vit, për herë të parë futjen në ligjin e buxhetit të një formulë të re të financimit të Universiteteve Publike. Kjo rriti objektivizmin në përdorimin e fondeve publike nga Universitetet, si dhe shmangu ndërhyrjen e MASH-it në vendimmarrje dhe në shpërndarjen e tyre. Nëpërmjet koeficientëve garantohen interesat e sektorëve të ndryshëm të IAL-it, si dhe kontrolli me efikas i shpenzimeve nga auditi i MASH. Kjo praktikë e re rriti transparencën në planifikimin dhe alokimin e fondeve të buxhetit.
- Në zbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe të Ligjit nr. 9131, datë 06.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, MASH ka ndërmarrë një nismë për evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, për të gjithë punonjësit në çdo DAR/ZA.
- Me Udhëzimin nr.41, datë 08.12.2009, “Për procedurat e njohjes së diplomave dhe çertifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”, MASH synon të lehtësojë procedurat e njohjes së diplomave, duke rritur dhe transparencën e këtij procesi. Udhëzimi parashikon vetëm 45 ditë nga dita e dorëzimit të dokumentave, deri në njohjen e diplomes.
- Me Urdhërin nr. 292, datë 11.09.2009, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupeve të monitorimit të procedurave të regjistrimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë, në programe të ndryshme të studimit të ciklit të parë më kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010”, MASH realizoi monitorimin e procesit të regjistrimit, për të evituar në këtë mënyrë çdo parregullsi si dhe çdo tentativë korruptive.
- Me Udhëzimin nr. 34, datë 02.11.2009, “Për organizimin e veprimtarive në shërbim të nxënësve në Arsimin Parauniversitar” të MASH, mësuesit që janë në marrdhënie pune në sektorin publik nuk mund të kryejnë kurse private. Kjo redukton praktikën korruptive të vërejtura deri më sot.
- Veprimtaria e Sektorit të Inspektimit dhe Monitorim – Vlerësimit, ka goditur veprimet korruptive në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Të gjitha rastet e shkeljeve të vërejtura nga inspektimet janë shoqëruar me masa disiplinore dhe administrative.

- Konsolidimi i mëtejshëm i planifikimit financiar në sistemin arsimor vazhdon, nëpërmjet forcimit dhe rritjes së transparencës së planifikimit vjetor me anë të PBA.
- Reforma kurrikulare e arsimit bazë dhe të mesëm, ka rritur dukshëm mundësinë e futjes së temave të ndryshme mbi antikorrupsionin, në disa lëndë mësimore.

Ne fushen e shëndetsisë

Po përgatitet një reforme e thelle dhe aktualisht përpjekje po behen për të krijuar një sistem të ri ligjor me transparent i cili do të reduktojë korrupsionin në këtë fushë. Disa masa dhe arritje janë:

- Amendime në Ligjin Nr. 9323, datë 25.11.2004 *“Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”* nëpërmjet Ligjit Nr.10 137, datë 11.5.2009, *“Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*.
- Nxjerrja e Urdhëri Nr 35 datë 22.01.009 *“Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e VKM Nr 1661 datë 29.12.2008 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”*.
- Në muajin dhjetor është amenduar Ligji Nr. 9323, date 25.11.2004 *”Per Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”* në të cilin është përmirësuar ndjeshëm procedura e regjistrimit të barnave, dhe me konkretisht neni 17, *“Për procedurën e përshpejtuar të regjistrimit”*. Në vazhdim të zbatimit të këtij neni po punohet për të nxjerrë rregulloret e regjistrimit për të krijuar një procedurë sa më transparente.
- Është miratuar rregullorja nr. 73 dt. 03.02.2009, *“Per regjistrimin e barnave në Republikën e Shqipërisë”*. Miratimi i kësaj rregullore ka sjellë rritje të numrit të barnave të rregjistruara në Shqipëri me procedurë të përshpejtuar. Procedura e përshpejtuar e regjistrimit aplikohet vetëm për barnat e rregjistruara në Agjencinë Europiane të Vlerësimit të Barnave (EMA), në Administratën Amerikane për Ushqimin dhe Barnat (FDA), në Zvicër, në Kanada, Australi si dhe barnat e rregjistruara sipas procedurave komunitare.
- Miratuar ligji Nr.10 043, datë 22.12.2008, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7870, datë 13.10.1994, Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.
- Është miratuar VKM Nr 1661 datë 29.12.2008, *“Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”*. Ky Vendim është ndryshuar gjatë vitit 2009 me Vendimin nr. 210, datë 25.2.2009, *“Për një ndryshim në vendimin nr.1661, datë 29.12.2008 të Këshillit të Ministrave, Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga*

skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. Janë kontraktuar nga ISKSH të gjitha Spitalet sipas detyrimeve të përcaktuara në VKM-te e sipërcituara.

Ministria e Shëndetësisë ka miratuar gjithashtu standartet e spitaleve dhe treguesit e cilësisë dhe të performacës:

- Urdher nr. 144, datë 2.03.2009, “ *Për miratimin e treguesve të performancës spitalore dhe matjes së tyre*”.
- Urdher nr. 258, datë 29.04.2009, “*Për miratimin e standarteve të cilësisë për spitalet*”.
- Urdher nr. 52 date 12.10. 2009, “*Per zbatimin e sistemit te referimit te pacienteve ne sherbimin shendetesor*”. Nëpërmjet këtij urdheri synohet reduktimi i korrupsionit që mund të shkaktohet duke mos u respektuar ky system por duke shkuar vetë pacienti tek mjeku specialist. Në urdhër parashikohet se mosrespektimi i sistemit te referimit nga personeli mjekesore penalizohet me kushtin penal.
- Udhezim nr 558 datë 26.10.2009, “*Për rregjistrimin, identifikimin dhe lëvizjen e pacientit brenda institucioneve shëndetësore në zbatim të sistemit të referimit*” Udhezimi synon të organizoje lëvizjen e pacientëve brenda institucionin shëndetësore duke përcaktuar vendosjen e zyrave të recepsionit dhe arkëtimit si dhe duke përcaktuar si pikë të parë kontakti recepsionin.
- Urdher nr. 559, datë 26.10.2009, “*Për aplikimin e tarifave të shërbimeve mjekësore që ofrohen ndaj pacientëve në sistemin shëndetësor*”.
- Urdher nr. 95, date 16.02.2009, “*Për miratimin e paketës bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor*”.

Ne fushen e Prokurimeve Publike

Miratimi i Ligjit nr. 10.170, datë 22.10.2009, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”*”, të ndryshuar.

Masa kryesore për shmangien e korrupsionit është aplikimi i sistemit elektronik te prokurimeve publike për të gjitha procedurat e prokurimit sipas VKM 659, datë 03.10.2007, “*Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik, me mjete elektronike*” dhe VKM 45, datë 21.01.2009 “*Per kryerjen e procedurave te prokurimit publik, ne mënyrë elektronike*”. Realizimi i prokurimeve nëpërmjet sistemit elektronik është një procedurë e re e aplikuar tashmë në të gjitha procedurat e prokurimit dhe ka rezultuar si efektive ne shmangien e veprimeve të parregullta apo korruptive të autoritete kontraktore apo operatoreve ekonomik. Zvogëlimi i procedurave të zgjatuara ka shtuar numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, duke shtuar konkurrencën dhe cilësinë e shërbimeve.

Komisioni i Prokurimit Publik është autoriteti i cili tashme shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit (krijuar në 2009 ndërkohë që anëtarët e tij janë emëruar me VKM-në e datës 10.03.2010).

- Në këtë kuadër Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRr), ka filluar e para aplikimin e prokurimit elektronik që në vitin 2008. Si rezultat i kësaj në vitin 2008 niveli i kursimeve në investime ka qenë 7% kundrejt fondit limit dhe në vitin 2009 ky kursim ka kapur shifrën 21%. E njëjta situatë paraqitet edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës – Kanalizimeve ku aplikimi i prokurimit elektronik ka filluar në vitin 2009, dhe si rezultat i kësaj niveli i kursimit për këtë vit ka qenë 8%.

- Ndërsa në shëndetësi mund të përmendim Udhezimin Nr 83 datë 9.2.2009, “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të përqëndruara të prokurimit në shërbimin spitalor publik në RSH*”, Udhezimin nr 730 datë 28.12.2009, “*Mbi mënyrën e organizimit dhe realizimit të disa procedurave të përqëndruara të prokurimit publik në Ministrinë e Shëndetësisë për të gjithë institucionet që financohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së shëndetësisë*” si dhe Udhezimin nr 731 datë 28.12.2009, “*Mbi mënyrën e organizimit dhe realizimit të procedurave të përqëndruara të prokurimit publik në shërbimin spitalor*”. Sipas këtij udhëzimi prokurimi për medikamente dhe materiale mjekimi do të kryhet nga Spitalet në nivel qarku.

Ne fushën e lejeve të ndertimit

Jane marrë masa të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndertimit. Këtu mund të përmendim amendimin e ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “*Per urbanistikën*”, miratuar me Ligjin nr.10078, datë 16.02.2009, botuar në fletorë zyrtare nr. 22 mars 2009 fq 1392.

- Ofrimi i shërbimit “one stop-shop” në lidhje me disa prej shërbimeve
- Në ligjin e vjetër, pajisja me leje ndertimi detyronte kalimin në dy procedura: leje sheshi; leje ndertimi. Amendimi ofron mundësinë e bashkimit të procedurave në një të vetme dhe miratimin e njëkohshëm të lejes së sheshit dhe lejes së ndertimit.
- Kërkesa konsiderohet e pranuar në heshtje dhe dokumentacioni i përcillet për shqyrtim dhe miratim KRRT-së së njësisë vendore atëherë kur njësi e urbanistikës, në përfundim të afatit 35-ditor, nuk dërgon në adresë të kërkuarit njoftimin:
 - i. mospranimin e shqyrtimit administrativ të kërkesës;

- ii. depozitimimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejes së ndërtimit në KRRT në përfundim të procedimit për shqyrtim administrativ të kërkesës;
- Parimi i miratimit të heshtur parashikon përgjegjësi penale, sipas ligjit, për shkelje me dashje të dispozitave për kalimin për miratim të lejes së ndërtimit. Kalimi për miratim i lejes së ndërtimit, qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, në shkelje të kushteve urbanistike për dhënien e lejes së ndërtimit, të parashikuara në këtë ligj, përbën mospërbushje të rregullt të detyrës.

Ne fushën e Licensave

Ne kuadër të masave anti-korrupsion janë vënë në zbatim ligjet Nr.10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Q.K.L- së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Këto akte ligjore kanë sjellë si rezultat përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet liberalizimit dhe de-burokratizimit të sistemit të licencimit në tërësi dhe në veçanti lehtësimin e procedurave të licencimit nëpërmjet një qendre të vetme, uljes së afateve të procedurave të licencimit dhe pakësimit të kontakteve me subjektet fizike dhe juridike në zyrat e licencimit në MPPT, si dhe uljen e kostos për bizneset që operojnë në këto fusha.

Me miratimin e ligjit nr. 10081 date 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” është krijuar dhe funksionon duke filluar nga data 9 Qershor 2009, Qendra Kombëtare për Licensim, e cila tashmë ofron shërbimin me një ndalesë për licensimin dhe dhënien e lejeve që me parë siguroheshin në Ministri të ndryshme. Kjo qendër punon sipas parimit të miratimit në heshtje. Për grupin e I dhe të II licensat jepen nga vete QKL brenda 2-4 diteve. Për licensat e grupit të III, të cilat përcillen pranë ministrive të linjes, koha e dhënies së licensave është 10-30 dite. Qendra Kombëtare e Licensimit ofron shërbime të shpejta dhe transparente për bizneset e interesuara për marrjen e një license apo leje, ku aplikantët mund të kontrollojnë në çdo kohë statusin e aplikimeve të tyre dhe të shohin listën e të gjitha lejeve dhe licensave të miratuara, duke menjanuar në këtë mënyrë kontaktet e drejtperdrejta me nëpunësit e QKL.

- Në fushën e Transportit Ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus sipas VKM Nr.1295, datë 29.12.2009, shkurtohet afati i dhënies së licensës nga 30 në 10 ditë.(MPPT)

- Komisionit i Miratimit te Lejeve ka miratuar 246 Leje Mjedisore e krahasuar kjo me vitin 2008 perkon me nje rritje ne 12%. Nga 24 leje qe jepte MMPAU, aktualisht sot leshohen vetem 5 te tilla.(MMPAU)
- Miratuar udhezimi Nr. 1457, date 28.07.2009, “Per proceduren e shqyrtimit te kerkesave per licensim, te subjekteve qe kryejne veprimtari te formimit profesional” në zbatim te kësaj VKM-je.(MPCSSHB)

Amendimi i një pjesë të ligjeve të sistemit shëndetësor që prekin licensimin e veprimtarive shëndetësore duke perfshire aktet e meposhtme: (MSh)

- Ligji Nr. 9323, datë 25.11.2004, “Për barnat dhe shërbimi farmaceutik”
- Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 9928, datë 9.06.2008, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në RSH”
- Ligji Nr. 8876, datë 4.04.2002, “Për shëndetin riprodhues”
- Ligji Nr. 9739, datë 21.05.2007, “Për shërbimin e trasfuzionit të gjakut në RSH”
- Ligji Nr. 8193, datë 6.02.1997, “Për transplantin e organeve”
- Ligji Nr. 7975, datë 26.07.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”
- Ligji Nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”

Me Hartimin e Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.913, datë 26.8.2009 “Për krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike” eshte lehtesuar procesi i leshimit te licensave, te lejeve, autorizimeve dhe akteve te tjera administrative per ndjekjen e te gjitha llojeve te projekteve, **ne fushen e energjise elektrike**, nga te gjitha burimet e mundshme, nepermjet bashkerendimit te procedurave per dhenien e licensave apo lejeve nga institucionet a entet publike perkatese. Kjo qender funksionon si nje one stop shop per te informuar dhe keshilluar subjektet private per kriteret dhe procedurat per licensimin, lejimin apo autorizimin e projekteve ne fushen e energjise elektrike.

Ne fushen e Koncesioneve

Me Hartimin e ligjit nr.10 157, datë 15.10.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. nr. 9663 date 18.12.2006 “Per koncesionet” eshte krijuar **Agjencia e Koncesioneve**, e cila lidhet drejtperdrejt me ankimimet per shkeljet e procedurave per koncesionet. Ligji rrit pergjegjesite dhe detyrat e kesaj Agjencie e cila vihet nen varesine e Kryeministrit dhe ka kompetenca deri ne marrjen e masave administrative dhe vendosjes se gjobave ndaj personave qe shkelin ligjin. Agjencia e Koncesioneve

propozon ndryshime ne procedurat apo aktet ligjore e nenligjore per te permiresuar punen, heton rastet korruptive dhe i denoncon ato ne Prokurori etj. Me perpara keto procedura (pa kompetencat e reja) i kishte nje sektor i brendshem Agjencia e Prokurimit Publik.

Po zbatohen për qytetet e Tiranës dhe Durrësit nga DPSHTRr-ja procedurat e testimit elektronik të njohurive teorike të kontrollit të kandidateve për drejtues mjete dhe brenda majit 2010 ato do të zgjerohen në të gjitha drejtoritë e vendit.

Planifikimi i territorit

Me miratimin e Ligjit nr.10119, datë 23.04.2009, “*Për planifikimin e territorit*”, janë përcaktuar standardet bazë të transparencës, fakt i cili parashikohet si mase anti-korrupsion. Çdo autoritet i planifikimit mund të miratojë procedura që garantojnë nivele më të larta të standardeve të transparencës, pjesëmarrjes së publikut e të vendimmarrjes, por nuk mund të cenojnë standardet bazë të përcaktuara në këtë ligj. Sipas këtij ligji, çdo vendim i autoriteteve të planifikimit duhet të jetë në përputhje me procedurat për pjesëmarrjen dhe aksesin e publikut në shqyrtimin e diskutimin e instrumenteve të planifikimit dhe vendimmarrjen për zhvillimin e territorit.

Standardet bazë janë:

- A. *Pjesëmarrja e publikut në shqyrtimin e projekteve të instrumenteve të planifikimit;*
 - a. *Çdo person ka të drejtë të informohet dhe të bëjë vërejtje e propozime, me gojë ose me shkrim, gjatë hartimit, shqyrtimit, miratimit dhe ndryshimit të instrumenteve të planifikimit të territorit dhe për çështje të tjera të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit të territorit, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.*
 - b. *Çdo person ka të drejtë të marrë pjesë në çështjet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit me kërkesa, opinione dhe mjete të tjera të ngjashme.*
- B. *Aksesi i publikut në dokumentet e planifikimit*
 - a. *Autoritetet e planifikimit i sigurojnë çdo personi e pale të interesuar akses të gjerë, për të konsultuar dhe për të marrë, pa pagesë ose kundrejt një pagese të përshtatshme, sipas koston së riprodhimit, një kopje të dokumenteve të mëposhtme:*
 - b. *instrumentet e planifikimit dhe rregulloret e kontrollit të zhvillimit, të miratuara nga autoritetet e planifikimit;*
 - c. *studime planifikuese, propozime e miratime të zhvillimit dhe vërejtje e propozime për çdo projekt-akt të planeve dhe të rregulloreve të kontrollit të zhvillimit, që përdoren për zbatimin e këtij ligji;*
 - d. *kushtet e procedurat, që zbatohen për kërkesat për zhvillim, lejet e zhvillimit, të ndërimit dhe të përdorimit, deklaratimet paraprake të punimeve, njoftimet e palëve, ankimet ndaj vendimeve të marra, sipas dispozitave të këtij ligji.*

- C. Çdo palë e interesuar ka të drejtën për akses e informim të gjerë pa pagesë, qoftë edhe para çdo veprimi publik, në të gjitha studimet e planifikimit, planet, rregulloret, propozimet e zhvillimit dhe miratimet e zhvillimit, përfshirë ato të zbatuara nëpërmjet “miratimit të heshtur”.
- D. Çdo dokument vihet në dispozicion për informim ose jepet një kopje e tij, në bazë të kërkesës së paraqitur me shkrim, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- E. Çdo autoritet i planifikimit duhet të afishojë ose të shpallë publikisht rregullat e tij për sigurimin e aksesit në dokumentet zyrtare në fushën e planifikimit, tarifat e zbatueshme dhe mënyrën e vendin e paraqitjes së kërkesave për akses të publikut në këto dokumente.
- F. Çdo autoritet i planifikimit boton në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit projekt-aktet dhe aktet e nxjerra prej tij, gjatë procesit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

Gjithashtu, **Regjistri i Planifikimit të Territorit**, është një faktor i ri, parashikuar në ligjin nr.10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”. Regjistri, është një inventar publik, i dokumentuar në mënyrë elektronike dhe në letër, në të cilin regjistrohen dhe administrohen, në mënyrë të pavarur nga autoritetet kombëtare dhe vendore, të dhënat për tokën, projekt-aktet dhe aktet e planifikimit, kërkesat për zhvillim dhe lejet e zhvillimit, të ndërtimit apo të përdorimit, së bashku me të drejtat apo kufizimet ligjore, që rrjedhin prej tyre, si dhe studime apo materiale të tjera me interes për publikun, që nga niveli kombëtar i planifikimit e deri në nivelin vendor.

Çdo autoritet i planifikimit regjistron të dhënat sektoriale në regjistër dhe i boton ato. Autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucionet e tjera publike kontribuojnë proporcionalisht në ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit. Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit. Mund të botohet në regjistër, me nismën e autoritetit përgjegjës të planifikimit, çdo akt tjetër që nuk është i detyrueshëm për botim, literaturë, metodologji, studime dhe çdo njoftim me interes për publikun. Projekt-aktet dhe aktet që janë të detyrueshme për botim në regjistër botohen menjëherë.

Reforma në fushën e të drejtës së pronësisë

Në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, vazhdon plotësimi me akte nënligjore dhe konkretisht është miratuar VKM nr. 224, datë 19.02.2009, “Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)” dhe Udhëzimi nr.2, datë 08.04.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e procedimit të

organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)”, si dhe ka përfunduar ngritja e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë.

Në periudhën tetor 2008 – nëntor 2009 në komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë janë paraqitur 9673 kërkesa nga individë dhe institucione (për shfuqizim të plotë të aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTBP), për shfuqizim të pjesshëm të AMTBP, për korigjim të AMTBP, për rishqyrtim të AMTBP sipas vendimit gjyqësor, verifikim të AMTBP, pushtim toke bujqësore në pronësi shtetërore, konflikte territoriale dhe të ndryshme) dhe janë marrë 693 vendime, nga të cilat 92 janë vendime për shfuqizim të plotë të AMTBP, si raste që kanë përfituar padrejtësisht pasi nuk kanë qënë subjekt i ligjit për tokën. Këto vendime nuk janë vendime përfundimtare, pasi janë objekt i shqyrtimit në rrugë gjyqësore.

Ne fushen e financave publike dhe administrimit financiar

Në kuadër të **forcimit të kontrollit të brendshëm në sektorin publik** përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe forcimit të kapaciteteve institucionale dhe njerezore, është miratuar dokumenti i Leter-Politikave për KBFP, me VKM nr.640, datë 11.06.2009 *”Për miratimin e leter-Politikave për KBFP dhe të planit të veprimit, 2009-2014”*. Nderkohe, deri në fund të 2009 përfundoi drafti i parë i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ai i ligjit për inspektimin financiar si dhe drafti për amendimin e ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007 *“Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”* dhe të tre draftet u derguan në strukturat e BE-se (DG Budget, Bruksel) për t’u vlerësuar dhe për të dërguar komente. Pritet që këto ligje të miratohen gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2010 nga Parlamenti.

Arritje të tjera gjatë vitit 2009 janë:

- Kompletimi i strukturës së Njesisë Qëndrore të Harmonizimit për strukturat e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm me kater punonjes.
- Fuqizimi i njesisë qëndrore për harmonizimin e strukturave të Auditimit Brendshëm.
 - Konkretisht janë zhvilluar katër trajnime lidhur me detyrat e stafit të dy njësive qëndrore: FMC (menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm) dhe Auditimi i Brendshëm. Është punuar dhe për përgatitjen e trajnereve për trajnimin e punonjësve të sistemit të KBFP/PIFC (në bashkëpunim me projektin PIFC-II).

- Drafti i Manualit mbi procedurat e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm ka përfunduar nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim. Ky draft është hedhur për diskutim në Komitetin e PIFC-ut dhe grupet e interesit.
- Është hartuar drafti i Manualit mbi procedurat e auditimit të brendshëm në sektorin publik, nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë në kuadër të projektit PIFC-II. Ky draft është hedhur për diskutim në të gjitha grupet e interesit si dhe u është dërguar me shkrim të gjitha strukturave të auditimit të brendshëm për komente. Ky draft pasqyron ndryshimet ligjore si dhe siguron një përputhje me të mirë me standardet dhe praktikën ndërkombëtare. Pritet që manuali të përfundojë rreth muajt Maj 2010 dhe të miratohet nga Ministri i Financave deri në fund të muajt Qershor 2010.

Ka vazhduar puna për **thjeshtimin e sistemit të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit** të shtetit, përmes zbatimit dhe konsolidimit të ligjit nr. 9936 date 26.6.2008 “*Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, Ligji i ri organik i buxhetit saktëson përgjegjësitë për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

- Është përforcuar lidhja ndërmjet buxhetit vjetor, PBA-së dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe strategjive sektoriale përmes adoptimit të Sistemit të Integruar të Planifikimit. *(Deri në fund të 2009 përfundoi faza e dytë e programimit buxhetor afatmesëm për periudhën 2010-2012, me përgatitjen e versionit përfundimtar të dokumentit. Në këtë proces, për herë të parë u përfshinë të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre. Për herë të parë, në këtë proces, nga institucionet buxhetore është konceptuar paraqitja e kërkesave për buxhet mbi bazë programi dhe produktesh duke realizuar deri diku lidhjen e politikave me shpenzimet.)*
- Në kuadër të zbatimit të ligjit baze të menaxhimit të sistemit buxhetor, është kryer caktimi i roleve të nepunësive të parë autorizues, të nepunëve autorizues dhe të nepunëve ekzekutues, duke mundësuar kështu ndarjen mes përgjegjëshmërisë politike dhe asaj menaxheriale. Kështu, rritet transparencja dhe përgjegjëshmëria në përdorimin e fondeve publike. Janë emëruar nepunësit autorizues dhe ekzekutues në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
- Ligji i ri për menaxhimin e sistemit buxhetor përcakton procedurën të qarta për marrëdhëniet fiskale ndërqeveritare, duke ia nënshtruar standartetë të njëjta me ato të pushtetit qendror. Rritja e transparencës dhe objektivitetit në përcaktimin e transfertave për pushtetin vendor është realizuar përmes përmirësimit dhe konsolidimit të formulës të shpërndarjes së transfertes së pakushtezuar. Për ciklin e buxhetimit aplikohen procedurën të njëjta me ato të njëjtit të qeverisjes qendrore. Formula e shpërndarjes së transfertes së pakushtezuar dhe kriteret për shpërndarjen e grantit konkurrues janë pjesë integrale të dokumentit të buxhetit.

Ne **sistemin e administrimit tatimor** rezulton se:

- Ka patur progres ne procesin e informatizimit te sistemit tatimor. Deri ne fund te 2009 u perfshine ne sistemin e integruar tatimor 13 drejtori rajonale.
- Eshte zgjeruar ndjeshem numri i deklarimeve dhe pagesave *on line* te detyrimeve tatimore per TVSH, Tatimin mbi te Ardhurat Personale dhe Kontributet (total 57,826 deklarime on line per TVSH, 18,468 deklarime per kontributet dhe 20,590 deklarime per TAP, per vitin 2009).
- Per perzgjedhjen e subjekteve per kontroll nga administrata tatimore perdoret analiza e riskut, bazuar ne deklaratat tatimore qe disponon sistemi i integruar kompjuterik (SIT) dhe te dhenat e derguara nga drejtorite rajonale.
- Jane thjeshtuar disa procedura, permes ndryshimeve ne aktet nenligjore, si ajo e rimbursimit te tatimeve te paguara me teper, vecanerisht lidhur me TVSH (ndryshimi i fundit i ligjit te procedurave, vendos detyrimin per rimbursim te TVSH brenda 30 diteve nga kerkesa, dhe ne rast mos pergjigje, subjekti ka te drejte te kompensoje shumen e pa rimbursuar me detyrime te tjera).
- Jane vene ne funksionim disa mekanizma lehtesues per denoncimin e akteve korruptive dhe marrjen e informacionit nga publiku, me venien ne funksionim tw numrit pa pagese 08001414 dhe adresen elektronike denoncime@tatime.gov.al si dhe jane kryer trajnime per punonjesit e administrates tatimore qendrore dhe lokale, per rritjen e kapaciteteve profesionale dhe menaxhuese.
- Eshte kryer rishikimi i struktures se Drejtorise se Mbledhjes te te Ardhurave. Ne bashkepunim me USAID eshte zbatuar projekti pilot per Drejtorine Rajonale Tatimore Tirane dhe DRT Tatimpaguesit e Medhenj, lidhur me hartimin e nje rregullore per funksionimin e “Njesise se Verifikimit” per saktesimin e procedurave te punes mes Drejtorise se Perpunimit dhe Drejtorise se Mbledhjes.
- Gjate 2009 eshte punuar per konsolidimin e struktures antikorrupsion ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve (Drejtoria e Investigimit te Brendshem dhe Antikorrupsionit, e krijuar me ligjin nr. 9920, date 18.5.2008 te procedurave tatimore), duke draftuar kuadrin nenligjor per funksionimin e saj dhe manualin perkates te funksionimit.
- Ne Maj te vitit 2009 u nenshkrua memorandumi i bashkepunimit ndermjet Prokurise se Pergjithshme, Ministrise se Brendshme, Ministrise se Financave, SHISH, ILDKP dhe KLSH, per krijimin e njesive te perbashketa hetimore, me qellim rritjen e efektivitetit te luftes ndaj korrupsionit. Jane caktuar personat e posacem nderlidhes me te gjitha njesite e perbashketa hetimore.

- Ne zbatim të akt-marreveshjes mes DPT dhe DPD është bërë bllokimi i operatoreve ekonomike që kanë patur detyrime të pashlyera ndaj organit tatimor. Në total janë derguar në prokurori 71 çeshtje. Gjithashtu ka patur raportime më të mira nga DPD në lidhje me Importet dhe Eksportet e subjekteve tatimore si dhe rekordime ditore të degeve të thesarit me drejtorite rajonale tatimore për të ardhurat e realizuara.

Ne vijim të punës për reduktimin e hapësirave për korrupsion **ne dogana** përmes thjeshtimit dhe modernizimit të Sistemit Doganor dhe procedurave doganore, me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit të kontrolleve rezultojnë se:

- U punua gjatë 2009 për kompletimin e infrastrukurës për monitorimin me kamerë të gjithë sistemit doganor nga qendra operative (realizuar pjesërisht), me asistencë të huaj për specifikimet teknike. Është ngritur sistemi i plotë i Skanimit të mjeteve dhe kontejnerëve, me instalimin e skanerit Mobil me Rreze x për kontrollin e kontejnerëve dhe automjeteve, në degen e doganës Durrës
- Deklarimi doganor *on line* ka ulur kohën dhe koston e zhdoganimit; ka rritur transparencën për operatorët e biznesit dhe shkëmbimin e informacionit me agjensitë e interesuara; ka ndikuar në rritjen e efikasitetit të kontrolleve nëpërmjet monitorimit *on line*. Deri në fund të 2009 përfundoi ndërtimi i sistemit IT: Asycuda World, në versionin Web
- Është ulur përqindja e kontrolleve fizike (deri në fund të 2009 ishte 16.5%), përmes rritjes së zbatimit të profileve të riskut për kontrollin e mjeteve/ngarkesave/subjekteve në pikat e kontrollit doganor.
- Grupi i punës i ngritur posaçërisht, ka hartuar projekt-aktet për ngritjen e Sherbimit Inteligent Doganor.
- Me qëllim përmirësimit të aftësive menaxhuese në nivel dege, rajoni dhe në të gjithë nivelet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, janë realizuar trajnime të ndryshme (458 persona) në drejtim të: Etikës në Sistemin Doganor, Menaxhimit Operacional dhe Ndergjegjesimit për planet operationale të BE.

Po zbatohet “Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit të Republikës së Shqipërisë”. Në këtë kuadër:

- Janë kryer kontrolle të përbashkëta në kufi për automjetet në Qafe-Thane dhe Kakavije.
- Janë shkëmbyer pikat e kontaktit në nivel qendror e lokal, është caktuar oficeri nderlidhës për sallën operationale të Policisë së Kufirit.
- Janë kryer trajnime të përbashkëta të oficerëve të policisë dhe doganës, janë kryer inspektime të përbashkëta në Pika të Kalimit Kufitar.

- Eshte realizuar projektimi, financimi dhe instalimi i 26 kabinave te perbashketa ne 5 Pika te Kalimit Kufitar: Hani i Hotit, Morine/Kukes, Qafe-Thane, Kapshtice dhe Kakavije.
- Eshte ne vijim procesi i venies ne funksionim i Qendres Nderinstitucionale Operative Detare – miratuar VKM perkatese ne Shtator 2009, eshte caktuar personeli i sherbimit nga DPD, perfunduar pershkrimi i punes perkates, vijon puna e Grupit te Punes per pergatitjen e Procedurave Operacionale.
- Eshte kontraktuar dhe jane vendosur 3 portale te reja fikse te detektimit te radioaktivitetit ne Morine/Kukes, Vlore dhe Kakavije.
- Eshte miratuar VKM per bashkepunimin me Policine e Kufirit per Regjimin e Lejimit te Prekohshem te automjeteve me targa te huaja – eshte ne proces diskutimi draft Udhezimit zbatues.
- Eshte pergatitur dhe miratuar me Urdher te Ministrave te Brendshem, te Financave dhe te Bujqesise rregullorja e perbashket e sherbimeve qe operojne ne kufi: Sherbimi Policor, Doganor dhe ai Veterinar.

Me qellim forcimin e strukturave organizative te Administrates Doganore

- Është plotësuar Sektori i Etikës dhe është në proces hartimi i një rregulloreje për këtë sektor dhe Kodi i Etikës për Administratën Doganore.
- Eshte ne proces ngritja e Qendres se kontaktit prane D.P.Doganave per administrimin e kerkesave dhe ankesave te publikut.

Forcimi i Drejtorisë se Kontrollit Pas Zhdoganimit dhe rritja e transparencës ne kryerjen e kontroleve pranë operatoreve ekonomik.

Ne fushen e kontrollit dhe hetimit

Policia e Shtetit

Ne zbatim te objektivave te planifikuara ne planin e veprimit per parandalimin dhe luften kunder korrupsionit per vitin 2009 rezulton se;

- Ne kuader te zbatimit te kuadrit ligjor mbi denoncimin e korrupsionit nepermjet linjave te posaçme te korrupsionit, Policia e Shtetit (Drejtoria e Pergjithsme e Policise) ka vene ne dispozicion te publikut per denoncimin e korrupsionit linjat e posaçme telefonike, si ne qender ashtu dhe ne te gjitha Drejtorite e Policise ne Qarqe. Gjithashtu ne faqen zyrtare te Ministrise se Brendshme (Policise se Shtetit) jane te afishuara numrat telefonike dhe kontaktet e nevojshme ne sherbim te publikut per denoncimin e veprave penale perfshire ketu dhe korrupsionin.

- Ne drejtim te konsolidimit te hetimit, eficences se ndjekjes penale dhe forcimit e zgjerimit te informatizimit, Drejtoria Kunder Krimet Financiar ka shtuar kapacitetet investiguese te saj.
 - Gjate vitit 2009 eshte krijuar nje Sektor i ri per Krimet Kompjuterike.
 - Puna per krijimin e nje Sektori te ri per Hetimin e Aseteve Kriminale perfundoi ne Janar 2010.
 - Ne vitin 2009 eshte krijuar nje seksion i ri per krimin ekonomik dhe korrupsionin ne Komisariatin e Policise Kavaje.
- Bazuar ne Urdherin nr. 1210, dt 02.11.2009 “*Per miratimin e plotesimin, regjistrimin e formulareve qe administrohen ne sistemin memex*“, ka filluar puna per te pasuruar dosjet e drejtimit me informacione, relacione, studime etj. Ne sistemin memex kane akses per hedhjen dhe shfrytezimin te dhenave te gjitha specialistet e Drejtorise ne qender, ndersa ne Drejtorite e Policive ne Qarqe u eshte dhene akses per konsultimin sipas drejtimeve, Shefave te Sektoreve dhe Seksioneve. Sistemi *memex* eshte implementuar ne te gjitha qarqet.
- Ministri i Brendshem ka nxjerre Urdherin nr 251 date 15.02.2008 “*Per hartimin e statistikave te kriminalitetit*“.

Persa i perket permiresimi te mekanizmave per hetimin e akteve te korrupsionit, eficences e ndjekjes penale dhe garantimit te statistikave periodike, jane bere ne menyre permanente dhe specifike analiza per çdo procedim penal te regjistruar per vepren penale te korrupsionit, nisur kjo dhe nga specifika e hetimit te ketyre lloj veprash. Ne te gjitha rastet e hetimit te ketyre lloj veprave jane perdorur me sukses te gjitha metodat speciale te hetimit, pergjime te te gjitha llojeve, vezhgime, filmime, si dhe veprime stimuluese dhe perdorimi i agjentit te infiltuar, bazuar ne Kodin e Proceduren Penale.

Gjithashtu;

- Persa i operket konsolidimit dhe eficences se hetimit, nisur nga rezultatet pozitive te njesise se perbashket task force per hetimin e krimet ekonomik dhe korrupsionit prane Prokurorise se Rrethit Tirane (Memorandumi i bashkepunimint Maj 2007), eshte neshkruar nje memorandum i ri bashkepunimi, i cili percakton ngritjen dhe funksionimin e 6 njesive te reja prane Prokurorive te Rretheve. Nga Policia e Shtetit jane perzgjedhur per si pjese perberese e ketyre taks forcave 20 specialiste.
- Stukturat e D.P.P.Sh jane trajnuar ne menyre te vazhdueshme persa i perket Luften Kunder Korrupsionit dhe vecanerisht njohjes dhe perfeksionimit te teknikave speciale per hetimin e ketyre veprave penale. Gjatire vitit 2009 nga Departamenti i Trajnime Policore, Prokuroria, D.K.K.E.F, si dhe partneret Nderkombetare OBDAT, PAMECA, BKA , TAIEX, etj, jane kryer 20 trajnime

ku janë trajnuar 434 punonjes policie, nga Departamenti për Hetimin e Krimeve dhe Departamenti i Kufirit dhe Migracionit .

Persa i përket bashkepunimit dhe bashkerendimit të brendshëm dhe nderkombëtar, përveç njësive të përbashkëta hetimore Task Force, mund të përmendim;

- Marreveshjen e përbashkët date 20.10.2005, nr 3368 prot, mes MB (DPPPSH), MF (DPD dhe DPT) si dhe MPPTT (DPSHTR), “ *Mbi bashkerendimin dhe bashkeveprimin ndërmjet strukturave, mbi luftën kundër krimit të organizuar, krimit ekonomik dhe korrupsionit*”.
- Memorandum bashkepunimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe AAPSK, date 29.09.2009, nr. 5660 prot. “*Me qëllim bashkerendimin dhe shkëmbim të informacionit për identifikimin, gjetjen dhe ruajtjen e pasurive objekt konfiskimi*”.
- Memorandum bashkepunimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe ILDKP, date 30.03.2009, nr 1973 prot. “*Me qëllim luftën kundër korrupsionit parandalimin, pastrimit të parave, konflikt të interesave, veprimeve që cenojnë funksionimin e administratës publike dhe mbrojtjen e interesave të Shtetit*”.
- Edhe Manuali i Procedurave Standarte të Hetimit të Krimit, miratuar në vitin 2009 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, në kapitullin 6 të tij, parashikon bashkepunimin ndërmjet strukturave të policisë së shtetit dhe agjensive të tjera të zbatimit të ligjit në Shqipëri.

Persa i përket të dhënave konkrete rezultojnë që për veprat penale të korrupsionit pasiv dhe aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike dhe korrupsionin në sektorin privat, janë evidentuar **52** raste me **112** zyrtarë të proceduar penalisht, prej të cilëve **60** të arrestuar.

Vlen të theksohet se gjatë këtij viti si rrjedhojë e punës profesionale të strukturave të Policisë së Shtetit, për dokumentimin e veprave penale të korrupsionit në fushën e drejtësisë, për herë të parë është bërë e mundur heqja e imunitetit dhe vënia përpara drejtësisë e dy gjyqtarëve, përkatësisht të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykatës për Krime të Rënda Tirane si dhe arrestimi i një prokurori të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane.

Strukturat e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm pranë Ministrisë së Brendshme

Gjatë vitit 2009, pas miratimit të ligjit të ri Nr. 10002, datë 06.10.2008 “*Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme*”, SHKB-ja si një nga agjencitë

ligjzbatuese pati zhvillime të reja pozitive të cilat konsistojnë në rritjen e pavarësisë të institucionit, forcimin e kapaciteteve administrative, caktimi dhe manaxhimi i buxhetit, krijimi për herë të parë i strukturës së inspektimit, trajnimi i personelit dhe rritja e aftësive operacionale hetimore.

Në aspektin ligjor, ka përfunduar miratimi i paketës së akteve nënligjore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatimin të ligjit të ri të SHKB-së.

1. **V.K.M nr. 477, datë 06.05.2009 “Për për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat e personelit hetues, në Shërbimin e Kontrollit të brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”.**
2. **V.K.M Nr. 478, datë 06.05.2009 “Për Klasifikimin e Niveleve, sipas funksioneve, të personelit Inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”.**
3. **V.K.M Nr. 637, datë 11.06.2009 “Për miratimin e Rregullores së Personelit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”;** kjo rregullore përcakton rregulla dhe procedura të qarta dhe të standartizuara për një zbatim efikas dhe të drejtë të Ligjit për SHKB-në dhe legjisllacionit që rregullon marrëdhëniet ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, me synim zhvillimin e një personeli të aftë dhe efektiv, si dhe zbatimin e të drejtave të punonjësve gjatë punës në SHKB.
4. **V.K.M Nr. 639, datë 11.06.2009 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve e të kontrollit të fondit të posacëm, në funksion të veprimtarisë informative dhe procedurale penale, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”;**
5. **V.K.M Nr. 646, datë 11.06.2009 “Për miratimin e Rregullores së Disiplinës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”;** kjo rregullore ka për qëllim të unifikojë veprimtarinë e strukturave e të punonjësve të SHKB-së, si dhe të përcaktojë mënyrën e zbatimit në praktikë të parimeve, normave dhe kërkesave në fushën e disiplinës, në funksion të respektimit të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të ligjit.
6. **V.K.M Nr. 718, datë 23.06.2009 ‘Për pagat e punonjësve të personelit të hetimit, të inspektimit dhe të shërbimeve mbështetëse, në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”;**

7. **V.K.M Nr. 42, datë 27.01.10 “Për përcaktimin e formës e të përmasave të stemës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme, dhe për mënyrën e përdorimit të saj”.**

Akte nënligjore të miratuara nga Ministri i Brendshëm

1. **Urdhri i Ministrit të Brendshëm, nr. 588, datë 03.03.2009 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së SHKB-së, në Ministrinë e Brendshme”.**

Janë në përfundim këto akte të tjera nënligjore

1. Rregullorja e Inspektimeve të Zakonshme
2. Udhëzimi për Inspektimet e Jashtëzakonshme
3. Udhëzimi për procedurat e zhvillimit të testit të integritetit
4. Udhëzim për procesin informativ
5. Udhëzim për përdorimin e fondit të posaçëm
6. Udhëzimi për bashkërendimin dhe bashkëveprimin e SHKB-së me strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe Policinë e Shtetit.

Në aspektin organizativ

- Me Urdhërin Nr. 588, datë 03.09.2009 të Ministrit, “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së SHKB-së,” SHKB-ja u ngrit në nivel administrativ nga Drejtori në Drejtori të Përgjithshme dhe u krijuan struktura të reja si Departamenti i Hetimeve, Drejtoria e Hetimeve dhe Testit të Integritetit, Drejtoria e Inspektimeve dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, në nivel qendror.
- Në nivel vendor, u krijua Drejtoria e SHKB-së së Tiranës me dy sektorë, e cila më parë ishte organizuar në nivel sektori. 11 seksionet e tjera të SHKB-së në qarqe në kuadër të këtij riorganizimi u ngritën në nivel sektori.
- Aktualisht ka filluar procesi i rekrutimit të punonjësve të SHKB-së për dy strukturat e reja, duke bërë shpalljen e vendeve të lira të punës në dy gazetata kombëtare me tirazh më të madh si dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme www.moi.gov.al. Ky proces do të përfundojë brenda muajit shkurt 2010 dhe në mars është parashikuar të fillojë trajnimi i personelit inspektues.
- Për herë të parë në vitin 2010, SHKB-ja ka dhe manaxhon buxhetin e saj si njësi shpenzuese brenda sistemit të Ministrisë së Brendshme. Për vitin 2010:

- Buxheti total **122 milion ose 900 mijë euro**
- Investime për blerje pajisjes **10 milion lekësh ose 75 mijë euro**
- Shpenzime operative **140 milion lekësh ose 110 mijë euro**
- Nga ky zë **5 milion lekë osë 35 mijë euro** është fondi sekret për shpërblimin e informatorëve.

Në aspektin funksional

Në bazë të misionit dhe objektit të veprimtarisë së saj SHKB-ja, funksionon si një agjenci mbikqyrëse e policisë dhe si agjenci anti korrupsion, me shtrirjen e objektit të veprimtarisë së saj vetëm brenda strukturave të Policisë së Shtetit, tek të gjithë sektorët dhe punonjësit me kompetenca operacionale dhe administrative pavarësisht nga grada dhe funksioni.

Kompetenca që konsistojnë në:

a)parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi paraprak i veprave penale të kryer nga punonjësit e policisë së shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada”

b)“inspektimi i punës së të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit, për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standartet e kërkuara, për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre”

c)SHKB në funksion të kryerjes së veprimtarisë së saj ka të drejtë të kryejë testin e integritetit për punonjësit e Policisë së Shtetit, i cili konsiston në aplikimin e teknikave dhe metodave që shërbejnë për verifikimin e etikës dhe intergitetin e një punonjësi të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu nga SHKB-ja janë kryer detyrimet ligjore që rrjedhin nga Urdhri i Ministrisë të Brendshme nr. 1174, date, 19.11.2007, “Për procedurat e te pastërtisë së figurës dhe dhënies së çertifikatës së sigurisë së punonjësve të MB“, janë kryer dhe kthyer përgjigje zyrtare institucioneve kërkuese, për **596** punonjës të Policisë së Shtetit, që kanë aplikuar për t’u pajisur me çertifikate sigurie, nga të cilët, për **32** prej tyre është kthyer përgjigje negative. Gjithashtu po në këtë kontekst janë kryer verifikimet dhe është dhënë mendim për **7** punonjës të SHISH-it, **5** punonjës të strukturave të tjera të Ministrisë Brendshme dhe për **10** punonjës të Gardës së Republikës.

Gjatë vitit 2009, ka vazhduar bashkëpunim i SHKB-së me agjencitë homologe të vendeve të Europës Juglindore dhe pjesmarrja e SHKB-së në aktivitete të realizuara në fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, si më poshtë:

- Ne dy seminaret e organizuara nga Drejtoria Kunder Pastrimit te Parave, ne Ministrine e Financave, ne kuader te Projektit Cards i binjakezimit Shqiperi 2009 me temat “Etika dhe Korrupsioni” dhe “Parandalimi i Korrupsionit ne Polici”, kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar **8** punonjës të SHKB-së
- Trajnimi me teme “Hetimet e Kontrollit te Brendshem dhe Inspektimet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi”, nga 11 Maj – 6 Qershor 2009, organizuar nga ICITAP, ku morën pjesë dhe u trajnuar **20** punonjës të SHKB-së.
- Nga data 24 – 25 Nëntor 2009, Budva, Mali i Zi u zhvillua Konferenca Rajonale e Agjencive Anti-Korrupsion të vendeve të Europës Juglindore, organizuar nga OSCE dhe Ministria e Brendshme e Malit të Zi. Në këtë konferencë me temë “Lufta Kundër Korrupsionit në Forcat Policore” mori pjesë **1** punonjës i SHKB-së.
- SHKB-ja mori pjesë në konferencën vjetore të (EPAC) Partnerëve Europiane Kundër Korrupsionit, nga datat 4 – 6 Nëntor 2009 në Nova Gorica, të Sllovenisë. Këtë vit SHKB-ja është bërë anëtare me të drejta të plota e këtij organizmi dhe do të vazhdojë bashkëpunimin në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira në fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit ndërmjet organizmave të mbikqyrjes policore dhe agjencive anti-korrupsion të vendeve anëtare të BE dhe KE.
- Nga data 09 – 10 Dhjetor 2009 në Sofie, të Bullgarisë SHKB-ja u zhvillua konferenca rajonale e Vendeve të Europës Juglindore organizuar nga Zyra e Programit Rajonal të UNDOC. Qëllimi i konferencës ishte forcimi i bashkëpunimit të vendeve të Europës Juglindore në implementimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit. Në këtë konferencë mori pjesë **1** punonjës i SHKB-së.
- Përfitues të Projektit Kundër Korrupsionit në Shqipëri (PACA) organizuar dhe financuar nga Komisioni European dhe Këshilli i Europës në vlerën 2 milion e 130 mijë euro SHKB-ja si agjencitë e tjera anti-korrupsion të zbatimit të ligjit për një periudhë 30 mujore (1shtator 2009 – 29 shkurt 2012).

Gjatë periudhës analizuese **Janar – Dhjetor 2009** nga SHKB-ja janë dërguar pranë organit të Prokurorisë gjithsejt **113** kallezime penale per **148** oficer policie ku **2** oficere të nivelit të mesëm drejtues, **42** oficere te nivelit te pare drejtues dhe **104** te nivelit zbatues. Persa i perket vepra korruptive jane derguar **56** kallezime penale per **80** oficer policie ku **2** oficere të nivelit te mesem drejtues, **24** oficer te nivelit te pare drejtues dhe **54** te nivelit zbatues, arrestuar ne flagrance **15** oficer policie.

Ne fushen e Mbrojtjes dhe Forcave te Armatosura

Strukturat e Ministrise se Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura gjate vitit 2009 kane raportuar;

- Rishikimin e Librit të Bardhë, duke përcaktuar më qartë veprimtarine e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në lidhje me strukturën, organizimin, burimet e tjerë, lidhur me rritjen e transparencës në veprimtarinë e institucionit.
- Në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr.9367, datë 07.04.21005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike“, janë ushtruar kontrole të vazhdueshme për parandalimin e emërimit në detyrë të personelit me konflikt interesi.
- Është arritur të reformohet në një shkallë më të lartë sistemi i buxhetimit, planifikimit të të ardhurave e shpenzimeve, duke përcaktuar kritere e masa për një planifikim të saktë e afatgjatë, me një pjesmarrje të gjërë e kompetente në diskutimin, analizën dhe mbikqyrjen e buxhetit, standartizimin e kontrollit të të ardhurave e shpenzimeve.
- Nëpërmjet zhvillimit të brifingjeve njohëse, për tema të ndryshme me personelin e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, është bërë ndërgjegjësimi i tij për çështje të luftës kundër korrupsionit.
- Futja e sistemit të tenderimit elektronik në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, ka rritur në një nivel të lartë parandalimin e veprimeve korruptive.
- Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës për procesin e punës, i gjithë sistemi i kontabilitetit dhe financës është informatizuar duke bërë të mundur rritjen e transparencës të aktivitetit të sektorit të financës dhe të forcimit të kontrollit në administrimin e bazës materiale në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve.
- Auditi i Brendshëm i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2009, ka realizuar gjithsej 54 misione auditimi, duke konstatuar se është shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 171 182 391 lekë. Krahas masave direkte janë bere kallzime penale per 10 punonjës. Staf i kesaj drejtorie eshte rritur nga 7 ne 28 auditues.
- Policia Kriminale në Batalionin e Policisë Ushtarake ka bashkëpunuar me prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe shërbimet e tjera homologe brenda dhe jashtë strukturave të FA-së, për zbulimin dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale. Keshtu jane dokumentuar 74 vepra te ndryshme penale nga te cilat 44 i jane derguar prokurorise. Nga keto vepra 8 rezultojne te jene klasifikuar si mitmarrje.

Ne strukturat e Ministrise se Puneve te Jashtme

1. Realizimi i masave në funksion të forcimit të bashkëpunimit me qytetarët dhe të thjeshtëzimit të procedurave të shërbimit ndaj tyre:

Pranë Drejtorisë Konsullore të MPJ ka funksionuar rregullisht Sektori i Marrëdhënieve me publikun, me një strukturë 1+2. Nga ky sektor janë trajtuar gjatë vitit 2009, 435 praktika, të cilat merrnin shkas nga letrat e ardhura nga shtetasit shqiptarë brenda dhe jashtë Shqipërisë, për probleme të ndryshme konsullore. Brenda vitit 2009 janë mbyllur (zgjidhur) 266 (ose 61%) praktika; të tjerat janë ende në trajtim, në varësi nga specifika dhe kompleksiteti i secilit rast të trajtuar. Ndër to janë trajtuar katër praktika që kanë konsistuar direkt në ankesa për trajtimin e problemeve të shtetasve shqiptarë nga Shërbimi konsullor jashtë vendit, apo në pikat kufitare. Këto raste janë trajtuar me përparësi dhe janë zgjidhur brenda periudhave kohore deri dy-javore.

Drejtoria Konsullore pranë MPJ, ka organizuar kontrole të veprimtarisë konsullore në disa Përfaqësi (Romë, Milano, Bari, Athinë, Selanik, Janinë) në të cilat ka qenë i pranishëm edhe një përfaqësues nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në MPJ. Mbi bazën e konstatimeve gjatë këtyre kontrolleve dhe të atyre të mëparshme:

- a) janë marrë masa administrative për disa punonjës konsullorë.
- b) është kryer hartimi i “Manualit Konsullor”, aktualisht shpërndarë dhe vënë në funksionim. I konceptuar si material-bazë për zhvillimin e veprimtarisë së përditshme konsullore të Përfaqësive, ky manual synon unifikimin e veprimtarisë së Shërbimit Konsullor të R. Sh. jashtë vendit. Ai siguron rritjen e transparencës në punën e Përfaqësive tona jashtë vendit, si dhe parandalimin e shkeljeve apo abuzimeve eventuale nga ana e punonjësve konsullorë. Manuali do të jetë gjithashtu materiali bazë mbi të cilin do të mbështetet auditimi i kësaj veprimtarie nga strukturat përkatëse në MPJ.

Në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun pranë Drejtorisë konsullore funksionon që prej tetorit 2009, një numër telefoni fiks, në dispozicion të publikut me qëllim lehtësimin e kontaktimit të kësaj zyre nga ana e qytetarëve, për të gjitha problemet që i përkasin fushës konsullore, si dhe veprimtarisë së Shërbimit tonë konsullor jashtë vendit.

Është bërë përditësimi me legjislacionin aktual i procedurave për pajisjen e shtetasve me pasaporta biometrike, si dhe rregullat për pajisjen e shtetasve të huaj me vizë hyrje në territorin e R. Sh., në faqen e MPJ në internet.

Ka filluar puna me modulën e-visa, nga MPJ së bashku me MB dhe SHISH. Aktualisht punohet për shmangien e problemeve teknike që eventualisht mund të hasen gjatë zbatimit të këtij Projekti. Në këtë mënyrë qarkullimi i informacionit është më i sigurt dhe më i mbrojtur. Është rritur gjithashtu shpejtësia e kryerjes së procedurave që nga momenti i aplikimit deri në miratimin e vizës. Për zbatimin e Projektit të plotë ka probleme për sigurimin e financimeve.

Procesi i legalizimit të dokumenteve si në MPJ ashtu edhe në Përfaqësitë jashtë vendit, kryhet vetëm me postë, duke shmangur kështu mundësinë e abuzimeve.

2. Fuqizimi i kontrollit të brendshëm ka qenë në qendër të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit në MPJ.

Nga 20 auditime të parashikuara janë realizuar 14, kjo për mungesë të fondeve buxhetore.

Në MPJ nuk është kryer auditim pasi nuk është gjykuar i nevojshëm nga titullari i Ministrisë, meqenëse ka ushtruar kontrolli i Lartë i Shtetit.

Punonjësit e Drejtorisë së Auditimit janë trajnuar rregullisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave. Janë realizuar 6 trajnime gjithsej.

Për sa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor, kjo drejtori ka detyrë funksionale dhënien e rekomandimeve të ndryshme si dhe jep kontributin e saj në lidhje me këto ndryshime. Konkretisht janë hartuar akte nënligjore në lidhje me blerjet me vlera të vogla, si dhe për administrimin e buxhetit. Për vitin 2010 është propozuar hartimi i një akti rregullator të përgjithshëm për përfaqësitë tona jashtë shtetit.

Drejtoria e Auditimit ka ndjekur periodikisht realizimin e detyrave të lëna nga çdo hallkë si dhe arkëtimin e dëmshpërblimeve. Mbetet problem vetëm për ata punonjës të cilët largohen nga shërbimi i jashtëm, kryesisht personel teknik, si shofer dhe të ngarkuar me financën.

3. Forcimi i statusit të diplomatit

Drejtoria e Burimeve Njerëzore e MPJ, në bashkëpunim me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, ka trajnuar rreth 22 punonjës të shërbimit të jashtëm në trajnimin me temë "Prezantim me administratën publike" dhe rreth 20 punonjës në trajnimet me tema të tjera të organizuar po nga ITAP.

Në bashkëpunim me Akademinë Diplomatike të MPJ-së janë ofruar 2 kurse trajnimi konkretisht në Bullgari dhe Kroaci ku janë trajnuar 4 punonjës të MPJ.

Të gjitha procedurat për pjesëmarrje në këto trajnime janë kryer me transparencë të plotë, pasi publikohen në rrejtin e brendshëm elektronik të MPJ-së dhe nëpunësit e interesuar parashetrojnë kërkesat për pjesëmarrje.

Përsa i përket procesit të aplikimeve të gradave diplomatike për vitin 2009 nuk është mbledhur Komisioni i Gradave dhe Disiplinës gjatë këtij viti.

Lidhur me procedurat e rekrutimit të nëpunësve civilë janë rekrutuar në MPJ sipas procedurave të konkurimit të parashikuar nga Ligji nr.8549 datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", 22 punonjës, të cilët kanë kaluar me sukses të dy fazat e testimit, të parashikuara nga ligji. Këto procedura janë kryer në transparencë të plotë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike, për çdo fazë të konkurseve, duke mbajtur në konsideratë se institucioni kompetent për administrimin e konkursit është DAP.

4. Reformimi i sistemit të buxhetimit dhe të planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve

Është ngritur Drejtoria e Planifikimit, Programimit dhe Financës, e cila funksionon si një strukturë eficiente, bashkëpunuese dhe e monitoruar. Brenda kësaj Drejtorie funksionojnë tre sektorë:

- a) Sektori i Planifikimit dhe Programimit
- b) Sektori i Financë-Zbatimit
- c) Sektori i monitorimit

Krahas kontrollit financiar të brendshëm, kjo drejtori ka punuar edhe në drejtim të ndërgjegjësimit të stafit të MPJ dhe të Përfaqësive diplomatike për përdorimin me efikasitet të fondeve, në përputhje me Ligjin dhe Plan-Buxhetin vjetor 2009.

Ne fushen e Mjedisit

Ne drejtim të forcimit dhe vazhimit të kontrolleve të ushtruara për aktivitetet e mjedisit, pyjeve, peshkimit dhe ujerave.

- Nga Inspektoriati i Mjedisit vetëm gjatë periudhës Janar-Qershor 2009 janë realizuar 1608 inspektime, ku 1500 janë inspektime të planifikuara dhe 158 inspektime të paplanifikuara në përgjigje të ankesave të komunitetit, institucioneve dhe autoriteteve vendore, Pas kontrolleve janë vendosur gjithsej 32 dënime me

gjohë në vlerën totale 29 500 000 lekë, 25 pezullime aktiviteti dhe 10 mbyllje aktiviteti.

- Nga Sektori i Peshkimit, inspektimet e realizuara në 6-mujorin e I-re të vitit 2009 janë 450. Nga ky sektor janë kryer konfiskime të ndryshme përfshirë dhe një anije të huaj. Janë marrë masa administrative për 61 subjekte me vlerë 22 200 Euro.
- Në bashkëpunim me subjektet e varesisë, Degen e Tatim Taksave dhe Organet e Pushtetit Vendor është bërë identifikimi i plote i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në mjedis dhe është krijuar lista e kontrollit të aktiviteteve mbi bazën e të cilave kryhen inspektimet.
- Policia Pyjore, gjatë 6-mujorit të parë 2009, ka kryer rreth 620 inspektime dhe ka mbajtur 76 proces verbale - penale me vlerë rreth 34 647 000 lekë dhe 427 proces verbale administrative me vlerë rreth 13.5 milionë lekë. Janë vendosur rreth 18.6 milionë lekë gjatë për kundravajtje në pyje dhe janë sekuestruar nga Policia Pyjore 317 m³ material drusor.
- Për të realizuar monitorimin e vazhdueshëm të shkallës së shfrytëzimit të inerteve lumore duke përbushur kriteret teknike të përcaktuara në aktet ligjore për 6-mujorin e parë 2009, nga inspektorët është bërë kontrolli periodik i shfrytëzimit ku rezultojnë të jenë përbushur gjithsej 191 inspektime kundrejt 210 inspektime të kryera për gjithë vitin 2008. Rritja e numrit të inspektimeve për 6-mujorin e parë të vitit 2009 rezulton të jetë 21%. Nga inspektimet e ushtruar 83 janë proces verbale konstatimi, 52 dërguar për kompetencë Inspektoriatit Ndertimor Urbanistik Kombëtar dhe 21 i janë dërguar për ndjekje Policisë së Shtetit.

Vazhdimi i zbatimit të reformës rregullatore si procedurë që i shërben lehtësimit të licensimit të aktiviteteve për përdorimin e burimeve natyrore ka bërë që;

- Numri i Lejeve Mjedisore të dhëna gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2009 është 246 (kundrejt vitit 2008 është rritur me 12%).
- Nga 24 leje që jepet MMPAU, aktualisht sot leshohen vetëm 5 të tilla. Vazhdon të ndiqet parimi parimi i “miratimit në heshtje”, për rastet të mospërbushjes brenda afatëve të detyrueshme nga ana e MMPAU-së.

Përsa i takon përmirësimin e kuadrit ligjor për përafrimin me vendet e BE, rezultojnë që;

- Për realizimin e këtij objekti është punuar nga drejtoritë teknike për organizimin e takimeve me grupet e interesit për amendimet e akteve ligjore ku pjesëmarrja e shoqatave dhe grupet e biznesit kanë shprehur mendimet e tyre.
- Për të fuqizuar rolin e OJF-ve dhe arganzatave e grupeve të tjera të interesit në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nga Ministri është miratuar Udhëzimi nr.1, datë 03.03.2009 “Për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar

pjesemarrjen e publikut dhe OJF-ve Mjedisore ne procesin e Vleresimit te ndikimit ne Mjedis”.

Perfshirja e grupeve te interesit ne diskutim eshte bere edhe per aktet ligjore si me poshte;

- VKM nr.241, date 06.03.2009 *“Per miratimin e listes se llojeve te huaja invazive dhe percaktimin e procedurave per ndalimin e futjen e tyre ne pikat doganore”.*
- VKM nr. 84, date 27.01.2009 *“Per caktimin e kriterëve per ngritjen e rrjetit te monitorimit dhe inventarizimit te biodiversitetit”*
- VKM nr.632, date 11.06.2009 *“Per miratimin e tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje”.*

Ne fushat e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta ka vijuar punen në drejtim te intensifikimit te luftës ndaj korrupsionit, dhe sigurimit te transparencës me publikun. Me konkretisht reformat kane konsistuar ne;

- Jane formuluar ndryshimet qe nevojiten per VKM nr.730, datë 6.11.2003 *“Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill”* dhe është hartuar projekt-vendimi *“Per caktimin e numrit të përfaqësuesve të Organizatave të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve në KKP”.*
- Ne bashkepunim me projektin “Fuqizimi i sherbimeve te punesimit dhe formimit profesional ne Sherbimin Kombetar te Punesimit” financuar nga qeveria italiane dhe qe zbatohet nga ILO, eshte hartuar metodologjia e kryerjes se vleresimit dhe monitorimit te programeve te nxitjes se punesimit.Jane perpiluar udhezimet per hartimin, monitorimin dhe vleresimin e programeve aktive te tregut te punes per persona qe rrezikojne te perjashtohen nga tregu i punes..
- U krijua Grupi i Punës për Rishikimin e Kodit të Punës, në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 275, datë 06.02.2009 dhe u hartua projekt-drafti perkates.
- Eshtë miratuar VKM nr.627, datë 11.06.2009 *”Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”*, hartuar nga Agjencia Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional në bashkëpunim me ministrinë e linjës.
- U hartua projektligji *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8872, datë 29.03.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”* ne bashkepunim me MASH dhe projektligji *“Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.*

- U miratua Udhëzimi nr. 1457, date 28.07.2009 “Per proceduren e shqyrtimit te kerkesave per licensim, te subjekteve qe kryejne veprimtari te formimit profesional” në zbatim te VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimeve”.
- Eshtë miratuar VKM nr.631, datë 11.06.2009 “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”.
- Eshte realizuar kuadri nënligjor në zbatim të Ligjit nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shqipëri” mbeshtetur nga PNUD dhe OSBE.
- Sanksionimi i kuotës në Kodin Zgjedhor.Futja e kuotës neutrale gjinore në masën jo më pak se 30 % në organet legjislativë, administrative dhe publike.
- Ngritja dhe funksionimi i sektorit “Për masa ndaj dhunës në familje”.
- Pas miratimit të Ligjit “Për të Huajt”, janë miratuar 13 akte nënligjore nga Këshilli i Ministrave, aktualisht po punohet për akte të tjera nënligjore që lidhen me Planin Kombëtar të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit.
- Është miratuar në Mars 2009 VKM “Për miratimin e dokumentit ndërsektorial Zhvillues dhe Planit të Veprimit për Moshimin”.
- U miratua VKM Nr 1201 date 03.12.2009 “Per miratimin ne parim te konventes se OKB per personat me aftesi te kufizuar”.

U miratuan VKM per pagesen e ndihmes ekonomike dhe aftesise se kufizuar si me poshte:

- Eshte miratuar VKM Nr 1235 date 16.12.2009 “Per nje ndryshim ne VKM Nr 869 date 18.06.2008 per zbatimin e ligjit nr 7889 date 14.12.1994 “Per statusin e invalidit” te ndryshuar.
- Eshte miratuar VKM Nr 1236 date 16.12.2009 “Per nje ndryshim ne VKM Nr 31 date 20.1.2001 “Per perfitimin nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar.
- Eshte miratuar VKM Nr 1237 date 16.12.2009 “Per nje ndryshim ne VKM Nr 787 date 14.12.2005 Per percaktimin e kriterëve dhe procedurave per perfitimin e ndihme ekonomike” te ndryshuar.
- Eshte miratuar VKM Nr 1238 date 16.12.2009 “Per nje ndryshim ne VKM Nr 78 date 04.02.2007 “Per masen kriteret dhe procedurat e perfitimit te nje pakete te vecante higjeno sanitare ,per invalidet, paraplegjike dhe tetraplegjike” te ndryshuar.
- Eshte miratuar VKM Nr 1240 date 16.12.2009 “Per nje ndryshim ne VKM Nr 277 date 18.07.1997 “Per perfitimin nga statusi i te verberit”.
- U miratua Udhëzimi i MPCSSHB nr. 1547, date 27.08.2009 “Per miratimin e kuotave te shpenzimeve per ushqime ne institucionet publike rezidenciale dhe komunitare te perkujdesit shoqeror”.

- Gjate vitit 2009 eshte miratuar VKM nr. 500, date 06.05.2009 “*Per disa shtesa ne VKM nr 751 date 07.11.2007 te KM “ Per miratimin e startegjise sektoriale te punesimit dhe te planit te veprimit per zbatimin e tij*”
- U miratua VKM nr. 500, date 06.05.2009 “*Per disa shtesa ne VKM nr. 751 date 07.11.2007 te KM “ Per miratimin e startegjise sektoriale te punesimit dhe te planit te veprimit per zbatimin e tij*”.
- Eshte pergatitur projekt ligji “*Per sigurine dhe shendetin ne pune*”.

Pervec ngritjes se zyres se pritjes se publikut, e cila ka shkurtuar procedurat per shqyrtimin e ankesave te qytetarëve per perfitimet nga asistenca sociale, sigurimet shoqërore, punësimin, migracionin etj., eshte fuqizuar kontrolli i brendshem duke bere qe ne vitin 2009 nga strukturat e auditimit te zbulohet nje dem ekonomik prej 8.2 milion lekë duke marrë edhe 34 masa disiplinore. Jane kryer gjithashtu nje sere trajnimesh dhe vazhdon puna ne disa projekte ne bashkepunim me institucione nderkombetare.

Ne fushat e Turizmit, Kultures e Sporteve

Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve ka raportuar nje sere nismash dhe masash te marra ne drejtim te transparences dhe minimizimit te hapsirave korruptive si me poshte:

- Ngritja nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e grupit të punës për reformën në artin skenik, me qëllim rishikimin e statuteve të institucioneve të varësisë dhe strukturave institucionale dhe ndërtimin e një platforme të “Menaxhimit Cilësor” të institucioneve të artit
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të nepermjet krijimit te Zyrave Rajonale për të Drejtën e Autorit për monitorimin e gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe pozicionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit në favor të autorëve dhe/apo interpretuesve, gjate proceseve gjyqësore në rastet kur kjo zyre thirret si palë e tretë.
- Rishikim i VKM” nr.202, datë 04/06/1963 “Mbi administrimin, ruajtjen dhe përdorimin e fondit shtetëror të librave” me objekt indeksimin e çdëmtimit të vlerës për librat dhe materialet e tjera bibliotekare.
- Propozimi i ndryshimit të VKM nr. 795, datë 26.11.2003, “*Për komisionin e vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore*”.
- Hartimi i Projekt-Vendimit “*Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar*”.

Nderkohe, ka vijuar puna ne sektorin e auditit te brendshem i cili raporton nje zbatueshmeri te masave te rekomanduara prej 76%.

Ne drejtim te mire-administrimit financiar dhe uljes se shpenzimeve

Në kuadër të reformës për përmirësimin e menaxhimit të shpenzimeve publike, si dhe të vazhdimin të filozofisë për një qeverisje me shpenzime administrative sa më të vogla, u miratua Ligji nr. 10.160, datë 15.10.2009, "**Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët e lartë dhe nëpunësit civilë**". Ky Ligj ul ndjeshem kostot e shërbimit të transporteve për funksionarët duke reduktuar në menyre drastike numrin e automjeteve e personelit në këto drejtim si dhe shpenzimet e mirmbajtjes. Funksionareve të cilët në bazë të akteve ligjore në fuqi kishin të drejten e automjetit dhe shoferit tashmë kompensohen financiarisht çdo muaj duke sjelle kursime të ndjeshme dhe duke pasqyruar një koncept të ri të administratës publike.

Bashkepunimi i publikut dhe shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.

Miratimi i Ligjit nr. 10093 dt.09.03.2009 për "**Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)**". Ky ligj synon të kontrollojë mënyrën e përdorimit nga OJF-të, të fondeve që do të jepen nga kjo Agjenci në formën e granteve.

Ligji i ri parashikon nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile në interes të publikut. AMSHC do të jetë enti publik që zbaton procedurat për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile. Kjo Agjenci udhëhiqet nga përparësitë strategjike të qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile. Një nisem e tillë do të conte në forcimin e OJF dhe Grupeve të interesit që punojnë në fushën e antikorrupsionit duke qenë se parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit është një prioritet i rëndësishëm i qeverisë shqiptare. Në përbërje të saj janë 9 anëtarë, nga të cilët 5 përfaqësojnë organizatat e shoqërisë civile dhe 4 përfaqësojnë institucionet e administratës publike qendrore. AMSHC-ja do të mbështesë dhe asistojë nisma dhe veprimtari me karakter jofitimprurës të organizatave të shoqërisë civile që janë aktive gjatë vitit fiskal në vijim, me përjashtim të partive e organizatave politike, sindikatave, institucioneve fetare. Në zbatim të tij janë miratuar dhe 2 VKM:

- VKM nr. 768 dt.15.07.2009 "Per miratimin e proceduarave dhe te rregullave per kandidimin dhe perzgjedhjen e anetareve te Bordit Mbikqyres te Agjencise per mbeshtetjen e Shoqerise Civile (AMSHC)".
- VKM nr. 769 dt. 15.07.2009 "Per miratimin e Statutit te Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile".